# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6262
E premte, 12 mars 2021
çmimi 0.40 €


## Pavarësisht prej rritjes së rasteve me Covid, masat e njëjta mbesin në fuqi
FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


40 VJET NGA DEMONSTRATAT E 11 MARSIT TË VITIT 1981 FAQE 4-5

# DEMONSTRATAT E '81-SHIT SHËNUAN KTHESËN E MADHE PËR LIRI



Në 40-vjetorin e demonstratave të marsit të vitit 1981 është vlerësuar se ndikimi i këtyre ngjarjeve në proceset e mëvonshme historike ka qenë i madh. Duke përkujtuar këto demonstrata, liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës kanë deklaruar se demonstratat e '81-shit shënuan kthesën e madhe të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Sipas tyre, ato demonstrata gjithëpopullore u shndërruan gradualisht në lëvizje rezistence për të drejta përmbajtjesore politike për shqiptarët

## LUFTA ÇLIRIMTARE E SHQIPTARËVE DHE HAGA

(Tri çështje për kundërvënie)

Prof. dr. Emin KABASHI

FAQE 6-7





## HARADINAJ KËRKON RINUMËRIM TË VOTAVE
FAQE 3

## OPINION

### PRITJET E QYTETARËVE SI OPOZITË E KURTIT F. 12

Shkruan: Adil BEHRAMAJ



### SA ISHTE SHQIPËRIA NË DIJENI PËR LËVIZJET E 11 MARSIT? F. 10-11

Shkruan: Bedri ISLAMI



### GJYSMËREFORMAT JANË TË RREZIKSHME SA GJYSMANALFABETËT! F. 14

Shkruan: Musli GUCATI



## AKTUALE

### GJYKATA SUPREME HEDH POSHTË NËNTË ANKESA KUNDËR VENDIMEVE TË PZAP-it F. 3

### PËRKUJTOHET 22-VJETORI I BETEJËS SË JESHKOVËS F. 8

## EKONOMI

### JAPONIA NDIHMON KOSOVËN ME DISA PROJEKTE NË VLERË MBI 320 MIJË EURO F. 9

### NGA 17 MARSI NUK DO TË ZHVILLOHET ASNJË LLOJ TRANSPORTI PUBLIK NË KOSOVË F. 9


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Hungaria dhe Polonia synojnë bllokimin e mekanizmit për buxhet



BRUKSEL, 11 MARS - Polonia dhe Hungaria janë duke sfiduar një mekanizëm të ri në buxhetin e Bashkimit Evropian, që lidh pagesat, me situatën rreth zbatimit të ligjit, për çfarë të dyja shtetet janë kritikuar ashpër. Mekanizmi i ri është krijuar në planin e shpenzimeve për periudhën 2021-27 dhe në paketën e rimëkëmbjes në vlerë të 750 miliardë eurove, e cila mëton t'i zvogëlojë pasojat e nxitura nga pandemia e koronavirusit në 27 vendet anëtare. Ky kusht mundëson bllokimin e fondeve nëse ka shqetësime për shkelje standarde, sikurse dëmtimi i pavarësisë së gjyqësorit.
Masa është kundërshtuar nga Polonia dhe Hungaria, shtete që janë kritikuar nga blloku evropian për çështje të lidhura me sundim të ligjit.
Të dyja shtetet kanë bllokuar miratimin e buxhetit të BE-së dhe paketën e ndihmës për shkak të këtyre mospajtimeve. Në një samit të mbajtur në dhjetor të vitit të kaluar, liderët e BE-së kanë arritur një kompromis, që nënkupton se mekanizmi nuk do të zbatohet derisa Gjykata Evropiane e Drejtësisë të vendosë për ndonjë ankesë të mundshme.
Më 11 mars Polonia ka njoftuar se ka dërguar ankesë në gjykatë për këtë çështje. "Ne besojmë se zgjidhje të tilla nuk kanë bazë ligjore në traktate, ndërhyjnë në kompetencat e vendeve anëtare dhe shkelin ligjin e BE-së", ka thënë zëdhënësi qeveritar Piotr Mueller në një deklaratë.
Në Budapest, Gergely Gulyas shefi i stafit të kryeministrit Viktor Orban, ka thënë se Hungaria do të nisë një rast të ngjashëm gjyqësor këtë javë.
"Ne jemi duke sfiduar rregullin mbi kushtëzimin para Gjykatës Evropiane të BE-së, bashkë me Poloninë", ka shkruar ministri i Drejtësisë, Judit Vargan, në rrjetin social "Facebook".

# I zgjedhuri i Bidenit konfirmohet prokuror i përgjithshëm



UASHINGTON, 11 MARS - Senati i Shteteve të Bashkuara konfirmoi të zgjedhurin e presidentit Joe Biden për prokuror të përgjithshëm. Senati votoi me 70 vota për dhe 30 kundër prokurorit Merrick Garland. Garland, 68 vjeç, do ta marrë përsipër udhëheqjen e Departamentit të Drejtësisë, pas një periudhe të trazuar nën ish-presidentin Donald Trump.
Trump ka insistuar që prokurori i përgjithshëm të jetë besnik ndaj tij personalisht.
Prokurori i parë i përgjithshëm i Trumpit, Jeff Session, ka dhënë dorëheqje pas presionit të presidentit, në lidhje me hetimet që ka bërë Departamenti i Drejtësisë për ndërhyrjen e Rusisë në zgjedhjet në ShBA.
William Barr, i cili ka zëvendësuar Session, ka dhënë dorëheqje në ditët e fundit të administratës Trump, pasi ai i ka hedhur poshtë pretendimet e tij të rreme për mashtrime të gjera në zgjedhje. Garland ka përvojë të gjatë në Departamentin e Drejtësisë, më së shumti si prokuror federal.

# Japonia shënon 10-vjetorin e tërmetit dhe cunamit masiv



Tokio, 11 mars - Japonia shënoi të enjten 10-vjetorin e tërmetit dhe cunamit masiv me një minutë heshtje. Tërmeti prej 9.0 shkallësh të Richterit - ndër më të fuqishmit në histori - goditi rajonin verior japonez më 11 mars 2011.
Dridhjet nxitën cunami, që shkatërroi qytete dhe shkaktoi rrjedhje radioaktive në centralin bërthamor Fukushim Daiçi.
Më shumë se 18 000 njerëz humbën jetën dhe gati gjysmë milioni u zhvendosën nga rajoni. Një dekadë më vonë, mbi 40 000 njerëz nuk mund të kthehen ende në shtëpitë e tyre. Shumica janë nga Fukushima, ku zonat përreth impiantit të shkatërruar kanë ende ndotje radioaktive.
Të mbijetuarit u lutën dhe kujtuan viktimat me një minutë heshtjeje në orën 2:46 - kohë kur ndodhi tërmeti.
Perandori Japonez Naruhito tha se Japonia duhet të mësojë nga e kaluara dhe të ndërtojë një komb më të fuqishëm për të ardhmen.
Qeveria japoneze shpenzoi rreth 300 miliardë dollarë për t'i rindërtuar shtëpitë, rrugët, linjat hekurudhore dhe infrastrukturat e tjera që pësuan nga fatkeqësia.

## Rregullatori evropian miraton vaksinën e kompanisë "Johnson & Johnson"

BRUKSEL, 11 MARS - Agjencia Evropiane e Ilaçeve ka miratuar vaksinën kundër koronavirusit, të kompanisë "Johnson & Johnson". Ky vendim vjen ndonëse kompania ka njoftuar ligjvënësit e Bashkimit Evropian se vaksina nuk do të ketë mundësi të dërgohet deri në mesin e muajit prill.
Kjo vaksinë tashmë është miratuar në Shtetet e Bashkuara dhe Kanada.
Për dallim nga vaksinat e kompanive të tjera, kjo vaksinë merret vetëm në një dozë. Rezultatet e testimeve me rreth 44 000 pjesëmarrës kanë treguar se vaksina e kompanisë "Johnson & Johnson" është 66 për qind efektive në parandalimin e sëmurjes së rëndë nga koronavirusi. Vaksina e kësaj kompanie bëhet e katërta që është miratuar nga blloku evropian.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Lutfi Haziri ka zyrtarizuar kandidaturën për kryetar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK)

# Pavarësisht prej rritjes së rasteve me Covid në Kosovë, mbesin në fuqi masat e njëjta

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 MARS - Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka mbajtur të enjten një takim me ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj, drejtorin e IKShPK-së, Naser Ramadani dhe me drejtorin e ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, në të cilin është vendosur të mbesin në fuqi masat e njëjta anti-Covid-19.

“Institucionet shëndetësore po funksionojnë me kapacitete të plota, furnizimi me barna është stabil, ndërsa deri në fund të muajit pritet të arrijë kontingjenti i parë prej 33 mijë dozave të vaksinës COVAX dhe menjëherë të fillojë vaksinimi i qytetarëve. Nga qytetarët kërkuam që ta respektojnë distancën fizike, ta përdorin maskën dhe të mirëmbajnë higjienën personale, ndërsa institucionet përgjegjëse ta shtojnë angazhimin për parandalimin, menaxhimin dhe kontrollin e infeksionit Covid-19 përmes respektimit rigoroz të masave në fuqi”, ka thënë Hoti pas takimit.



Autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar të enjten 632 raste të reja me Covid-19, pas testimit të 3 621 mostrave në institucionet publike dhe ato private.

Sipas Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK), më 11 mars janë regjistruar tetë viktima. “Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Ferizaj 3 raste (86, 77, 57 vjeç), Prizren 3 raste (79, 74, 65 vjeç), Podujevë 1 rast (77 vjeç), Prishtinë 1 rast (88 vjeç)”, është thënë në njoftim.

Në po këtë ditë virusin Covid-19 e kanë tejkaluar 397 persona, kurse 10 318 raste vazhdojnë të jenë aktive. Prej 13 marsit, kur janë regjistruar rastet e para me koronavirus në Kosovë, autoritetet e këtij vendi kanë regjistruar 75 380 persona të infektuar me këtë virus. Prej tyre, 1 682 kanë vdekur.

Më 11 mars të një viti më parë Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka shpallur koronavirusin pandemi.

# Haradinaj kërkon rinumërim të votave

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 MARS - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka kërkuar të enjten nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) rinumërim të plotë të votave të zgjedhjeve të 14 shkurtit dhe dënimin e keqpërdorueseve të votave. Pas mbledhjes së kryesisë të AAK-së ai u ka thënë mediave se partia që drejton është e shqetësuar me keqpërdorimet e votave që kanë ndodhur në disa raste nga komisionarë, të cilët i ka konsideruar të papërgjegjshëm.

“Kërkojmë nga organet e rendit, ligjit dhe hetuesisë, që kriminelët e votës të të gjitha partive të përfundojnë në burg. Ne nuk kontestojmë rezultatin e zgjedhjeve, nuk e di pse dikush duhet të jetë kundër rinumërimit”, ka thënë Haradinaj.

Ai, megjithatë, ka vlerësuar procesin zgjedhor të 14 shkurtit duke falënderuar të gjitha strukturat, vëzhguesit e komisionarët që kanë kontribuar për rregullsinë e këtyre zgjedhjeve. Lideri i AAK-së ka thënë se formimi i institucioneve të reja duhet të ndodhë sa më shpejt.

Pas ngritjes së dyshimeve për manipulim të votave në zgjedhjet e 14 shkurtit, Meliza Haradinaj-Stublla të martën, më 9 mars, ka thënë dorëheqje nga drejtimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës si dhe nga funksionet në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur më 4 mars rezultatin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit.

Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit ka shënuar fitore bindëse, duke siguruar 58 ulëse në legjislaturën e re. Sipas rezultatit përfundimtar, Partia Demokratike e Kosovës do të ketë 19 ulëse në kuvend, Lidhja Demokratike e Kosovës 15 dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës tetë deputetë.



# Gjykata Supreme hedh poshtë nëntë ankesa kundër vendimeve të PZAP-it



PRISHTINË, 11 MARS - Gjykata Supreme ka njoftuar të enjten se ka refuzuar nëntë nga 15 ankesat e pranuara kundër vendimeve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). Gjashtë ankesa të tjera është thënë se do të trajtohen në 72 orët e ardhshme. Ankesat u janë refuzuar: Anton Shalës, Nezir Çoçajt, Lëvizjes Vetëvendosje, Visar Hotit, Ismet Shamollit, Hisen Berishës, Lirie Kajtazit, Ekrem Hysenit dhe Gentrit Sylës.

Ankesat kanë qenë të lidhura me kërkesa për rinumërim apo manipulim të votave.

Ankesa e Adrijana Hoxhiqit, udhëheqëses së subjektit politik boshnjak “Komuniteti i Bashkuar-Adrijana Hoxhiq”, nuk është trajtuar ende. Ajo i është drejtuar Gjykatës Supreme për të kundërshtuar një vendim të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa që ia anuloi mbi 4 200 vota që i kishte siguruar në komunat e banuara me shumicë serbe.

Hoxhiqi e ka vlerësuar vendimin e PZAP-it, të marrë më 8 mars, “skandaloz dhe të papranueshëm” pasi, sipas saj, me anulimin e votave shkelen të drejtat themelore të qytetarëve të Kosovës. Ajo ka paralajmëruar se nëse Supremja nuk hedh poshtë vendimin e PZAP-it do të shfrytëzojë edhe instanca të tjera gjyqësore, duke aluduar në Gjykatën Kushtetuese dhe mekanizmat ndërkombëtarë.



40 VJET NGA DEMONSTRATAT E 11 MARSIT TË VITIT 1981

# Demonstratat e '81-shit shënuan kthesën e madhe për liri

Në 40-vjetorin e demonstratave të marsit të vitit 1981 është vlerësuar se ndikimi i këtyre ngjarjeve në proceset e mëvonshme historike ka qenë i madh. Duke përkujtuar këto demonstrata, liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës kanë deklaruar se demonstratat e '81-shit shënuan kthesën e madhe të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Sipas tyre, ato demonstrata gjithëpopullore u shndërruan gradualisht në lëvizje rezistence për të drejta përmbajtjesore politike për shqiptarët

EPOKA E RE Muhamet KOCI

**Prishtinë, 11 mars** - Kosova ka përkujtuar demonstratat e 11 marsit të vitit 1981. Në 40-vjetorin e këtyre protestave, liderë politikë dhe institucionalë të Kosovës kanë vlerësuar lart ndikimin e këtyre protestave në ngjarjet e mëvonshme. Ata kanë deklaruar se këto ngjarje shënuan kthesën e madhe në përpjekjet e popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi.

Ushtruesja e detyrës e presidentit të vendit, Vjosa Osmani, ka thënë se këto protesta u shndërruan gradualisht në lëvizje rezistence për të drejta përmbajtjesore politike për shqiptarët. "40 vjet më parë, më 11 mars 1981, refuzimi i pjatave në Mensën e Universitetit të Prishtinës nga rinia studentore e Kosovës, shënoi fillimin e demonstratave të cilat ishin kthesë historike jo vetëm për Kosovën, por edhe më gjerë. Kjo revoltë 'e bukës' u shndërrua gradualisht në lëvizje rezistence për të drejta përmbajtjesore politike për shqiptarët dhe shënoi fillimin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Prej këtu thirrja për Republikë u shndërrua në kauzë jo vetëm për përmirësimin e pozitës politike të shqiptarëve, por edhe për shtetin të cilin sot e gëzojmë", ka shkruar Osmani në llogarinë e vet në "Facebook", duke shtuar se studentët kanë mbajtur gjallë frymën e përpjekjes për liri. "Ky shpirt studentor mbajti gjallë përpjekjen për liri e pavarësi, për Republikën të cilën e bëmë realitet dhe të cilën duhet ta forcojmë edhe më tej. Si çdoherë studentët iu kanë paraprirë ndryshimeve në Kosovë. Ky ndryshim tashmë është realitet, ndaj sikur dikur kur ishin studentët që na unifikuan në kërkesën tonë për shtet, sot kemi nevojë sërish për një unitet të tillë që ta forcojmë shtetin e Kosovës, ta lartësojmë imazhin e tij dhe ta bëjmë një vend perspektive për rininë tonë!", ka shkruar Osmani.

Lideri i LV-së, njëherësh kandidat për kryeministër, Albin Kurti, ka thënë se studentët e asaj kohe ishin të organizuar dhe të vetëdijesuar si asnjëherë më parë për të kërkuar liri. "Sot, më 11 mars, shënojmë 40-vjetorin e demonstratave të fuqishme studentore, të cilat u bënë edhe gjithëpopullore në ballë të të cilave, përveç studentëve, ishin edhe punëtorët. Asokohe studentët u organizuan nga mensa, konviktet, universiteti për të drejtat e shqiptarëve për Kushtetutën dhe Kosovën në mënyrë që edhe ajo të jetë e barabartë përmes statusit të Republikës", ka deklaruar Kurti pasi ka vizituar ekspozitën "'Vullkani' i Republikës", e cila është hapur për nder të këtij përvjetori nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Sipas Kurtit, në këto demonstrata nuk kërkohej thjesht liria, por edhe barazia kushtetuese. "Demonstratat e vitit 1981, sikurse edhe çdo grup tjetër i demonstratave në historinë e shqiptarëve, ndodhen ndërmjet demonstratave të vitit 1968 për universitet dhe demonstratave të vitit 1988-1989, kundër suprimimit të autonomisë. Por e veçanta e demonstratave të vitit 1981 është se studentët ishin të organizuar dhe vetëdijesuar si asnjëherë më parë dhe në këtë mënyrë në emër të Kosovës kërkonin jo thjesht liri, por edhe barazi kushtetuese me popujt dhe republikat e tjera", është shprehur Kurti.

Demonstrata e '81-shit i kanë përkujtuar edhe liderët e tjerë politikë.

Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, duke kujtuar 40-vjetorin e demonstratave të vitit 1981, ka theksuar se pranvera e vitit 1981 shënoi moment kthese në historinë e Kosovës. "Demonstratat e nisura në mars të 1981-s i hapën rrugë luftës për çlirimin e Kosovës nga okupimi represiv serb dhe të drejtën për pavarësi. Për të



gjithë studentët dhe pjesëmarrësit në këtë demonstratë që përshpejtoi rënien e ish-Jugosllavisë shpreh respektin, mirënjohjen dhe konsideratën më të thellë për kontributin e pashoq për avancimin e çështjes së Kosovës", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka shtuar se populli i Kosovës asnjëherë nuk u ndal para shtypjes së regjimit serb. "Pavarësisht prej burgosjeve masive, rrahjeve, dënimeve, e vrasjeve, shpirti çlirimtar po forcohej më shumë se asnjëherë. Ky popull nuk e duron shtypjen. Ky popull nuk e duron padrejtësinë. Prandaj e arritëm çlirimin final të Kosovës dhe pavarësinë e saj", ka thënë Hoxhaj.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se më 11 mars të atij viti është pagëzuar Republika e Kosovës. "Dyzet vjet më parë shpërtheu shkëndija që paralajmëroi fillimin e zbrazjes së zemërimit popullor kundër padrejtësive, kundër shtypjes e shfrytëzimit. Ajo ishte dita që nisi një proces të pakthim. Më 11 mars u pagëzua Republika e Kosovës. Lavdi të rënëve!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facbook".

Kurse lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka vlerësuar se demonstratat e 11 marsit të vitit 1981 dhe demonstratat e mëvonshme të atij viti shënuan kthesën e madhe historike. "Sot u bënë 40 vjet nga organizimi i demonstratave studentore të vitit 1981, ku mijëra studentë anekënd vendit, profesorë universitarë dhe qytetarë të shumtë, zgjodhën rrugën e protestës kundër shtypjes që u bëhej nga regjimi i asaj kohe, si dhe për ta kërkuar avancimin e statusit politik të Kosovës nga autonomia në Republikë. Demonstratat e 11 marsit të vitit 1981 dhe demonstratat e mëvonshme të atij viti shënuan kthesën e madhe në përpjekjet e popullit tonë për liri dhe pavarësi. Në këtë ditë të rëndësishme ne kujtojmë dhe nderojmë me sinqeritetin më të madh të gjithë ata protestues, të cilët me vendosmëri dhe guxim të lartë artikuluan të drejtën e qytetarëve të Kosovës për Republikë", ka thënë Limaj.

### Edhe organizatorët përkujtojnë demonstratat

Demonstratat e marsit të vitit 1981 i kanë përkujtuar edhe organizatorët. Ish i burgosuri politik, Hydajet Hyseni, ka thënë se demonstratat e '81-shit i kanë bashkuar shqiptarët. "Neve na ka bashkuar pranvera e vitit 1981 [marsi i lavdishëm] dhe sot nuk jemi në situatë që të flasim gjerë e gjatë. Do ta bëjmë këtë në tryezën që do të organizojmë sot këtu në mensë dhe më pas në konferencat që do të organizohen më 26 mars në Institutin e Albanologjisë. Ajo që do të mund të përmendet në një kohë të tillë është fakti që në të kaluarën shqiptare marsi ka pasur një domethënie të veçantë", ka thënë Hyseni.

Edhe ish i burgosuri politik Gani Koci, i cili ka qenë ndër organizatorët e atyre demonstratave, ka vlerësuar se para 40 vjetësh ka nisur kthesa e madhe historike. "Sot e 40 vjet më parë nisi, si uragan, kthesa e madhe historike, për ta përmbysur robërinë! Nisi dhe nuk u ndal për asnjë çast, deri në çlirimin e kësaj pjese të atdheut të ndarë! Jam krenar që i takoj kësaj epoke, edhe si gjeneratë edhe si aktor i drejtpërdrejtë, që solli epokën e lavdishme të UÇK-së dhe lirinë e Kosovës", ka shkruar Koci në profilin e vet në "Facebook".

Më 4 mars 1981 studentët e Kosovës organizuan një protestë në Prishtinë për kushte më të mira në mensën e tyre dhe kjo protestë ishte shkëndija e demonstratës së organizuar nga ta më 11 mars 1981. Si pasojë e demonstratave të studentëve erdhën tubimet e njohura si "Demonstratat e punëtorëve", në të cilat kërkohej lirimi i studentëve të burgosur. Por përsëri organet shtetërore ndërhyjnë me tërë brutalitetin e tyre gjatë tubimeve dhe ish-armata jugosllave pushtoi rrugët e Kosovës dhe në tërë territorin u vendos gjendja e jashtëzakonshme, më vonë edhe shtetrrethimi.

## Hapet ekspozita "Vullkani' i Republikës"

Me rastin e 40-vjetorit të demonstratave të '81-shit, Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës ka hapur ekspozitën "'Vullkani' i Republikës". Në ekspozitën e hapur në platenë e Mensës së Studentëve në Prishtinë janë prezantuar dokumente të ndryshme. "Dokumentet e përzgjedhura për këtë ekspozitë janë fotografi, aktgjykime nga proceset e shumta, lajme gazetash dhe revistash legale e ilegale, raporte për shkrimet e mediave të huaja, pankarta dhe parulla që shpërndaheshin gjithandej Kosovës së asaj kohe, ndonjë letër doreshkrim që, kryesisht, në një formë ose në një tjetër, i përkasin vitit 1981 apo janë rrjedhojë e tij", ka thënë Bedri Zyberaj, kryeshef ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore i Arkivave të Kosovës.



# Lufta çlirimtare e shqiptarëve dhe Haga

## *(Tri çështje për kundërvënie)*



**Prof. dr. Emin KABASHI**
Instituti Albanologjik i Prishtinës
Këshilltar shkencor

Në Kosovë, nga viti 1997 e deri në qershor të vitit 1999, është zhvilluar luftë e armatosur kundër pushtuesit serb.
Në Kosovë janë vrarë, masakruar dhe djegur popullatë civile, e pambrojtur, e paarmatosur, kryesisht pleq, gra dhe fëmijë.
Në Kosovë janë vrarë edhe ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovë, por ata janë dëshmorë të kombit, deshi apo nuk deshi kushdo qoftë, që nga Kosova, Tirana dhe Evropa.
Të tjerët janë viktima të gjenocidit të Serbisë bërë në shqiptarë, të cilin, po ashtu, nuk është me rëndësi e pranon Serbia, Evropa, apo kushdo tjetër, sepse këto janë fakte historike.
Kjo është jeta historike e popullit shqiptar të Kosovës, i cili në vitin 2008 e ka shpallur pavarësinë e Kosovës, të kësaj pjese të atdheut tonë, Shqipërisë, e cila i ishte dhënë Serbisë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913. Pjesë të tjera i janë dhënë Maqedonisë së sotme të Veriut, Malit të Zi të sotëm dhe Greqisë.
Megjithatë, që nga Lufta e Dytë Botërore na kanë mjaftuar gjysmat, ashtu siç na i lanë të tjerët, qendrat e vendosjes në Evropë. Pas çlirimit të Kosovës, një herë të vetme, guxuan Sali Berisha, Hashim Thaçi dhe Ali Ahmeti dhe e kanë përmendur bashkimin kombëtare në Shkup. Vetëm njëherë. U hallakat Evropa, më keq se nga Korona Virusi 19, e morën vrap e në Beograd për ta bindur Serbinë, se nuk do të krijohet Shqipëria e Madhe, siç thonë serbët sa herë kanë frikë nga liria e shqiptarëve. Vrapoi Evropa ta qetësonte Serbinë, duke u thënë të mos kishin frikë, se ne i rregullojmë shqiptarët. Kurrë më, as ata, më vonë as Albin Kurti nuk e zunë në gojë bashkimin kombëtar.
Kurse procesin e madh historik të bashkimit kombëtar e ka hapur Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili do të bëhet një ditë, deshi apo nuk deshi Evropa, deshën apo nuk deshën shqiptarët e politikës së ditës.
Se çka ka ndodhur me shqiptarët dhe tokat e tyre dihet tashti më.
Historiografia shqiptare, më parë në Tiranë, pastaj edhe në Prishtinë dhe në Shkup i ka trajtuar dhe i ka studiuar rrethanat historike, në të cilat është bërë copëtimi i gjeografisë sonë kombëtare. Po askush, as atëherë, as sot nuk ka thënë se jemi kundër Evropës. Jemi vetëm kundër padrejtësive, sidomos kundër padrejtësive historike, nga kushdo që vijnë.
Mirëpo, vite pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, nën ndikimin e fuqishëm të Rusisë dhe të Serbisë, së bashku me vende dhe shtete që nuk e kanë njohur Kosovën, kishin filluar të përgatisnin terren për krijimin e një gjykate për krimet e luftës, që i paskan bërë shqiptarët.
Për çudi, në të gjitha shkrimet që merren me këtë temë, së pari akuzohet Dik Marti, një eurodeputet, i cili ka hartuar një raport me këtë titull: "Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi kundërligjor i organeve njerëzore në Kosovë", raport për gjoja krimet që paskan bërë luftëtarët shqiptarë. Ka përmendur emra luftëtarësh, që sipas tij, paskan bërë tregti me organet e njerëzve, kryesisht serb, po edhe ndonjë shqipfolës, që ishte bërë argat i dreqit, siç i quante Adem Demaçi.
Karla Del Ponte, pasi kryen mandatin e prokurores së shumëpaguar në Gjykatën e Hagës për krimet e ish-Jugosllavisë, ku nuk kishte harruar të akuzonte edhe shqiptarë, të gjithë luftëtarë të lirisë, edhe pse ish-Jugosllavia nuk ekzistonte më, edhe pse shqiptarët nuk ishin më pjesë e atij shteti artificial.
Mund të merret me mend, se Evropa u trondit nga themelet, veç që nuk thanë publikisht, se si është e mundur t'i kemi ndihmuar do shqiptarë që paskan qenë kriminel lufte.
Nga kjo tronditje, Evropa e thirri Këshillin e Evropës dhe ai nxori një rezolutë, ku u thuhej shqiptarëve, ose mblidhni mend, ose nuk jemi me ju. Si çdo shtet fëmijë, edhe Kosova, u frikësua, andaj lëshoi pe, edhe kur i kërkuan ta formojë një gjykatë speciale, që do të jetë e Kosovës, por me seli në Hagë, se po i frikësoni dhe po i vrisni dëshmitarët e mbrojtur, Kosova mbeti sa një grusht dhe u dorëzua.
Kështu pra, dhe gjykimi fillon nga kreu i kësaj ushtrie, pra janë ftuar dhe janë marrë, deri tashti, disa nga krerët e udhëheqjes së luftës çlirimtare.
Do të thotë, në një aktakuzë të përbashkët, gjykohen anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, si një grup i bashkuar kriminal.
Pra, këtu është prishur parimi i fajeve, mëkateve individuale, por pasi ishte luftë, ato qenkan krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, se ata serbët e vrarë, po edhe ata shqiptarët e Dik Martit e të Këshillit të Evropës, qenkan njerëz, andaj krimi është kundër njerëzimit, për të cilin na kanë mbushur kokën të gjithë evropianët, andaj edhe kjo gjykatë që selinë e ka në Hagë, edhe pse është e Kosovës, e themeluar me ligje të Kosovës, por ligje që nuk respektohen askund, duhet të gjykojë dhe t'i dënojë kriminelët.
Do të thotë, nuk gjykohen individët, por struktura udhëheqëse e luftës, gjë që nuk ka ndodhur me gjykimet në Gjykatën e Hagës për ish-Jugosllavinë, ku janë gjykuar e janë dënuar sa për të thënë, disa serbë, secili veç e veç, për rolin e tyre komandues që kishin pasur.
Në një varg shkrimesh te ne, qoftë në mjetet e informimit, por edhe në botime të veçanta (Bardhyl Mahmuti, Mashtrimi i madh, Prishtinë, 2015), Kudusi Lama, mbi tridhjetë vazhdime, Analizë e veprës së Dik Martit, Epoka e re, 2020), si dhe ndonjë shkrim tjetër, i janë nxjerrë të palarat këtij Dik Martit. Mendoj se Dik Marti ka kryer vetëm detyrën që i kishin dhënë, kurse shpërblimet që i kanë dhënë ata që ia kanë dërguar materialet inkriminuese, i paçin bërë mirë. Por, nuk e di, si do të dëshmojnë ata 200 e sa dëshmitar të Gjykatës Speciale të Kosovës, me seli në Hagë, nëse nuk kanë emra dhe mbierma, siç ka ndodhur rasti me furrën e gëlqeres në Kleçkë, që e kishin quajtur krematorium, kur as fëmijës serb, as nënës serbe, as gjyshes serbe, po as atyre 100 serbëve të vrarë, askush nuk ua dinte emrin dhe mbiemrin, përveç nëse emrat dhe mbiemrat e tyre i dinë Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi, Salih Mustafa, Nasim Haradinaj, Hysni Gucati, gjykimi i të cilëve ka filluar, dhe në aktakuzën e tyre shkruan se janë 100 serbë që i paskan vrarë këta luftëtarë të lirisë së Kosovës.
Por, as Karla Del Ponto, as Dik Marti, as Gjykata speciale në Hagë, nuk do të mund të organizonin këto gjykime, as t'i gjenin 200 e sa dëshmitarë, serbë, shqiptarë, ndoshta katolik, pasi këta kishin vrarë vetëm shqiptarë katolik, e komunitete të tjera, pa Rezolutën e Këshillit të Evropës, me votat e të cilit miratohet raporti i Dik Martit, plus me votat e tre shqiptarëve.
Vetë fakti se atë dokument e miraton dhe e shndërron në rezolutë, pra në ligj obligues, Këshilli i Evropës, në vitin 2011, do të thotë kjo është vepër e këtij Këshilli. Pastaj nga ky vit e deri më 2015 organeve të Kosovës së pavarur u është bërë një trysni e papare, me lloj-lloj argumentesh, duke e përfshirë këtu edhe Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ku të drejtën e vetos e kanë Rusia dhe Kina, përveç të tjerëve, të cilët po ashtu nuk e kanë njohur Kosovën. Pra, e kërcënonin Kosovën se do ta shisnin te Rusia dhe te Kina. Ruana zot, Rusia e Kina, shitur e pa shitur, na përpijnë, tha politika e ditës në Kosovë. Pra, prapaskena e gjithë trysnisë ishte që të hapej një gjykatë, ku do të gjykohej Lufta e UÇK-së, të cilën Evropa edhe sot e quan konflikt, edhe pse në atë konflikt, nga 24 marsi deri më 10 qershor të vitit 1999, një pjesë e shteteve evropiane edhe me SHBA-në, kishin dërguar avionët e tyre si pjesë e NATO-s, për të bombarduar caqet ushtarake serbe në Serbi dhe në Kosovë. Pra, nëse janë bërë krime, pjesëmarrëse në ato krime është edhe Evropa.
Nuk është aspak me rëndësi, cila ka qenë trysnia e Shteteve të Bashkuar të Amerikës ndaj atyre shteteve evropiane dhe ndaj NATO-s që të fillojnë dhe të përfundojnë ato bombardime.
Më tutje, dihet se deri në vitin 2008 në Kosovë ishin disa pushtete, UNMIK-u, EULEX-i KFOR-i, secili më i fuqishëm se tjetri, disa janë edhe sot e gjithë ditën, me të drejta të pakufizueshme për të bërë çka do që ju thoshte mendja, ngase kishin imunitet ndërkombëtar, ngase edhe kur vrisnin demonstrues paqësor, nuk i merrte kush në pyetje.
Këto struktura kanë organizuar gjykime aq të shumta, vetëm për ushtarët e UÇK-së, sa njeriu nuk mund ta marrë me mend se një vend, që është çliruar së bashku me NATO-n, tashti të ndiqet penalisht i veçuar, dhe për çudi, askush tjetër vetëm ushtarët e lirisë të UÇK-së, të cilët kishin marrë armët për të luftuar kundër pushtuesit, ani pse këto toka i kishte pushtuar Serbia bashkë me Evropën e vitit 1913. Po as dje, as sot, askush nuk ka thënë se shqiptarët janë kundër Evropës. Jo, shqiptarët janë



kundër padrejtësive historike, që na janë bërë për më shumë se një shekull.
Çudia e zotit, vetëm ushtarët e UÇK-së, përveç hajnave dhe kriminelëve ordiner i kishin mbushur burgjet e Dubravës, ku ishte bërë njëri nga krimet gjenocidiale ndaj të burgosurve shqiptarë të vitit 1999, burgjet e Lipjanit, Prishtinës, Mitrovicë, Prizrenit, Pejës, Gjilanit, e ku jo tjetër. A është marrë kush me këto burgosje dhe me këto gjykime, kur dihet se janë mbajtur me vjet të tëra, pa asnjë seancë gjyqësore, kur dihet se një pjesë e madhe e tyre janë shpallur të pafajshëm, por ama pasi kanë qëndruar nga tetë, apo dhjetë vjet nëpër burgje. Këto burgje në vend që të bëheshin vende përkujtimore, muze, e vende publike, siç është bërë tashti vonë burgu i Prishtinës, aty, në të njëjtin vend ku i mbante të burgosurit edhe pushtuesi serb, i mbanin edhe qeveritarët e UNMIK-ut, e të tjerët më radhë, deri te qeveria e Kosovës.
Por t'i kthemi Gjykatës speciale në Hagë. Gjykata e Kosovës, e themeluar nga Kuvendi i Kosovës, me seli në Hagë, ngase pushteti i Kosovës, nuk paska qenë në gjendje të bëjë sigurinë e dëshmitarëve të mbrojtur. Pse, cila paska qenë nevoja që të mbrohen, kur dihet se ata janë vendosur ku kanë dashur nëpër Evropë, disa prej tyre kanë ndërruar edhe identitetet, kanë marrë familjet me vete, e të tjera, e të tjera, gjë që Gjykata e Kosovës në Hagë e di më së miri. Kjo gjykatë e dhomave të specializuara, tashti ka lënë anash faktet e Dik Martit dhe të Këshillit të Evropës për trafikim të organeve nga ushtarët e UÇK-së, por këta paskan bërë krime ndaj serbëve, ndaj komuniteteve të tjera dhe ndaj shqiptarëve katolikë.
Vetëm ky përkufizim i aktakuzave të kësaj Gjykate dëshmon për anësinë e saj. Kjo anësi, se gjykohen vetëm shqiptarët, askujt nuk i bëri përshtypje as në Evropë, as në Amerikë, edhe pse të dy palët kanë qenë për krijimin e kësaj Gjykate.
Prandaj, qenka e logjikshme se këto krime i paskan kryer vetëm anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, apo edhe ndonjë komandantë i ndonjë Zone Operative. Nuk ka asgjë më të tejdukshme, se këtu nuk gjykohen individët, por Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Ato që thuhen në konferencat për shtyp, edhe nga Gjykata Speciale, edhe nga shtete të ndryshme të Evropës, janë fjalamani, që nuk i bën përshtypje as nxënësve të shkollës fillore në Kosovë. Se shqiptarët, kudo që janë, kurse në Kosovë veçanërisht, nëse nuk dinë asgjë, e kanë mësuar që më shumë se njëqind vjet kush na ka marrë lirinë, kush na i ka marrë tokat e atdheut, kush na ka vrarë dhe na ka masakruar, kush ka rrënuar çdo gjë në jetën tonë, dhe si për inat të historisë, ne ende jemi gjallë dhe jemi këtu, në Kosovën tonë, që një ditë, me procesin e bashkimit kombëtar, do të bëhemi komb modern, si të gjitha kombet Evropës. Besoj shumë, se do të jemi edhe tashti e tutje.
Kur Aleanca Veri Atlantike, pra NATO-ja kishte marrë vendim të bombardonte caqet ushtarake serbe, sigurisht nën trysninë e madhe të SHBA-ve, shqiptarët krijuan iluzionin se më në fund Evropa, po i pranonte padrejtësitë historike që ju kishte bërë shqiptarëve më shumë se një shekull. Por, të mençurit kanë thënë se iluzionet janë të dëmshme. Këtë e vërteton më së miri kjo Gjykatë Speciale me seli në Hagë, edhe pse është e Kosovës, gjoja se punon me ligje të Kosovës, edhe pse këto ligje as nuk i merr për bazë, me asnjë veprim, aq më keq, kur kjo Gjykatë arreston dhe gjykon vetëm shqiptarët.
Por, njësoj si Milloshevigi që në Gjykatën e Hagës për Ish-Jugosllavinë, kur përballej me dëshmitarë shqiptarë, merrej me pandehma, ne ia nxirrnim përpara faktet e realitetet konkret, të vrarët, të masakruarit, të burgosurit, të djegurit, si dhe rrënimet e çdo gjëje në jetën e shqiptarëve.
Edhe kjo Gjykatë speciale, sa duket paska harruar se ato dëshmi që i ka mbledhur nga dreqi dhe i biri, janë pandehma në krahasim me krimet dhe gjenocidin që ka kryer Serbia pushtuese në Kosovë. Sepse këtu nuk luftonin kundër shqiptarëve vetëm ushtria serbe, as vetëm policia serbe, as vetëm grupet e fuqishme paraushtarake, që ishin nën urdhrat e shtetit, as të burgosurit që u falej jeta vetëm të vinin e të vrisnin shqiptarë në Kosovë. Këtu kundër shqiptarëve luftonin edhe serbët vendor, pa marrë parasysh kishin ardhur si kolonizatorë, dje e pardje, apo kishin mbetur që nga Lufta e Dytë Botërore. Sepse ata ishin edhe përgjegjës për disa nga krimet më çnjerëzore që janë bërë gjatë Luftës së UÇK-së. Thirreni vetëm një shqiptar nga Krusha e Vogël, dhe ju thonë emrat të gjithë fqinjëve të tyre, që kanë bërë gjenocid mbi shqiptarët e këtij fshati. Aspak nuk është me rëndësi, ishin vullnetar në luftën e tyre të shenjtë për Kosovën si djep i Serbisë, si zemra e kombit hyjnor serb, apo ishin mobilizuar me urdhër të shtetit në Beograd, apo ishin mercenarë rus, që i paguante Serbia. Pra, le të thotë kjo Gjykatë Speciale, cili nga këta serbë vendor, që ka bërë krime të papara, është nxjerrë para gjyqit, kudo qoftë, në Serbi, apo në Hagë. Kjo gjykatë duhet ta dijë, sepse një pjesë e prokurorëve dhe gjykatësve të saj kanë qenë në disa mandate në Kosovë, qoftë si pjesë e UNMIK-ut, qoftë si pjesë e EULEX-it. Për çudi të zoti, asnjëri nga ta, si asnjëherë, nuk pati një grimë kurajo, së paku qytetare e të thoshte, po e kemi dënuar një serb, se fjala vjen në Fushë Kosovë, një qendër paraushtarake serbe në Kosovën tonë, ka vrarë shqiptarë të pafajshëm.
Përveç të gjithave sa u thanë, kjo Gjykatë, nëse nuk ia ka thënë kush deri tashti, le t'i thuhet, se shqiptarët e Kosovës, përkundër të gjitha të metave në qeverisje, përkundër lakmisë së madhe ogurzezë pas Luftës së UÇK-së, do ta kalojnë edhe këtë zezonë, por ama kjo na ka bërë mirë, sepse nga kjo Gjykatë e tutje së paku nuk do të kemi iluzione se na ndihmon Evropa, edhe pse Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte shkolla më praktike, se pa i ndihmuar vetes nuk të gjendet askush.
Prapëseprapë politika jonë e ditës, e cila ka pak peshë në jetën historike të popullit shqiptar, i paskësh ruajtur këto iluzione nëpër sirtarët e zyrave të tyre burokratike, ngaqë për demokraci kemi kohë ende.
Gjykata Speciale e Kosovës me seli në Hagë, edhe mund të dënojë një, dhjetë, njëqind, dy mijë, dhjetë mijë luftëtarë të lirisë por kurrë, me asnjë vendim, nuk mund ta dënojë luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo Gjykatë Speciale nuk mund ta zhbëjë Vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për të drejtën historike të Kosovës që të bëhet shtet. Kjo Gjykatë Speciale nuk mund ta kthejë historinë prapa, përveç nëse është e zonja të organizojë një Konferencë të Ambasadorëve në Londër, të vitit 1913, në mënyrë që pastaj Serbia të organizojë një Kuvend të Prizrenit të vitit 1945, që Kosova sërish të bëhet zemër e Serbisë dhe djepi i ortodoksisë sllave.
Ndoshta kjo Gjykatë Speciale e Kosovës, me seli në Hagë, nuk ka harruar se jemi në shekullin njëzet e një, në vitin 2020 dhe 2021, ku çdo gjë duhet të verifikohet saktë, mbi bazë të dhënave dhe fakteve, që mund të merren edhe në Selinë e NATO-s, edhe nga satelitë të asaj kohe, që kanë xhiruar çdo gjë, edhe nga arkivat e Uashingtonit, Berlinit, Londrës, Parisit, por edhe nga dëshmitë e pafundme të shqiptarëve, që janë dhënë për më shumë se njëzet vjet, disa shumë të rëndësishme edhe në Gjykatën e Hagës për ish-Jugosllavinë, ku janë dënuar edhe shqiptarët, vetëm se ishin luftëtarë të lirisë, vetëm se ishin ushtarë të një ushtrie çlirimtare të cilën Evropa ende e quan konflikt.



# Leona Musa zgjedhet kryetare e Asamblesë Komunale të Fëmijëve

MITROVICË, 11 MARS (ER) - Është zgjedhur struktura e re e Asamblesë e Fëmijëve në Komunën e Mitrovicës e cila do të kryesohet nga kryetarja Leona Musa, nënkryetarja Sara Keqa, dhe anëtarët e kryesisë, Suela Zasella, Erina Mustafa, Amar Neziri dhe Triumf Brahimi.

Asambleja komunale është formuar në bazë të Rregullores për themelim dhe strukturim të asamblesë së fëmijëve nga Njësia për të Drejtat e Njeriut e miratuar në Kuvendin Komunal, OJQ "Syri i Vizionit" dhe e mbështetur nga organizata "Save the Children". Teuta Uka nga OJQ "Syri i Vizionit" u tha asamblistëve të rinj se tani ata do të jenë mbrojtës të të drejtave të gjithë fëmijëve që jetojnë në territorin e Komunës së Mitrovicës. Ajo ka njoftuar se asamble të këtilla funksionojnë edhe në komunat e tjera të Kosovës.

Koordinatori i Njësitit për të Drejtat e Njeriut nga Komuna e Mitrovicës, Fitim Rama, u tha nxënësve asamblistë se ata, për t'i realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e asamblistit, duhet të angazhohen shumë, të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë përvoja.






# Përkujtohet 22-vjetori i betejës së Jeshkovës

PRIZREN, 11 MARS (ER) - Me rastin e shënimit të 22-vjetorit të betejës së Jeshkovës, kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me drejtorët komunalë, përfaqësuesit e organizatave të dala nga lufta, familjet e dëshmorëve, pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës, kanë bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve në Landovicë dhe pranë lapidarit dhe varrezave të dëshmorëve dhe martirëve në Jeshkovë. Me këtë rast, kryetari Haskuka ka thënë se sot kanë përkujtuar 21 dëshmorët e rënë në këtë betejë të lavdishme të UÇK-së, të cilët sakrifikuan jetën e tyre për t'i vënë themelet e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Po ashtu, kryetari Haskuka ka theksuar se lufta e UÇK-së është krenaria e kombit shqiptar.

# Biblioteka e Qytetit pajiset me 130 tituj të ri librash



PODUJEVË, 11 MARS (ER) - Dega e Shoqatës e Shkrimtarëve në Podujevë ka organizuar orën letrare në Bibliotekën e Qytetit, me ç'rast janë prezantuar pjesë nga krijimtaria letrare e shkrimtarëve dhe poetëve llapjanë të cilët për Bibliotekën e Qytetit dhuruan 130 tituj.

Në orën letrare të organizuar nga Shoqata e Shkrimtarëve në Podujevë, ku ishin të pranishëm kryetari i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, Shyqri Galica, poetja Flora Brovina dhe shkrimtarë të tjerë, poeti llapjan Ramadan Oraca prezantoi aktivitetet e Shoqatës së Shkrimtarëve në Podujevë të zhvilluara gjatë vitit të fundit.

Drejtoresha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Elhame Kutllovci, u shpreh e lumtur që Biblioteka e Qytetit dita-ditës po pasurohet me tituj të rinj. "Jam e lumtur që Biblioteka e Qytetit vazhdimisht po pasurohet me tituj të rinj, edhe me aktivitete letrare që po zhvillohen në këtë kuadër. Ne si DKRS, bazuar në mundësitë tona, do të jemi të vëmendshëm për mbështetje të poetëve dhe shkrimtarëve llapjanë për krijimtarinë e tyre letrare" tha drejtoresha Kutllovci.

Ndërsa kryetari i Shoqatës i Shkrimtarëve të Kosovës, Shyqri Galica, prezantoi historikun e shoqatës, aktivitetet e saj dhe titujt që ndahen në kuadër të programit të saj.

# Mbyllet përkohësisht Qendra për Pajisje me Dokumente në Fushë-Kosovë

FUSHË-KOSOVË, 11 MARS (ER) - Agjencia e Regjistrimit Civil e Ministrisë së Punëve të Brendshme ka njoftuar qytetarët e Republikës së Kosovës se në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Fushë-Kosovë një nga zyrtarët ka rezultuar pozitiv me Covid-19. "Për shkak të rrezikut nga përhapja e Covid-19, është marrë vendim që Qendra për Pajisje me Dokumente në Fushë-Kosovë të mbyllet përkohësisht deri në një vendim tjetër. Vetëm tërheqja e dokumenteve që janë të gatshme mund të bëhet në këtë qendër, ndërsa për gjitha aplikimet për dokumente qytetarët mund t'u drejtohen qendrave tjera me të afërta", ka njoftuar MPB-ja.



# Haziri mbështet fondacionin 'Vjosa'

GJILAN, 11 MARS - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur të enjten në takim themeluesin e fondacionit "Vjosa" me seli në Helsinki të Finlandës, Lulzim Bexheti. Haziri e ka përgëzuar Bexhetin për nismën, duke thënë se me këtë do t'u lehtësohet jetesa adoleshentëve autikë në Kosovë. Në fund, Bexheti e ka falënderuar kryetarin Haziri mirënjohjen dhe për ofrimin e mbështetjes së plotë për fondacionin "Vjosa".



Përsiatje politike / TRIADA E KOSOVËS (4)

# Shqipëria sa ishte në dijeni për lëvizjet e 11 marsit?



Shkruan: Bedri ISLAMI

Prekja e çështjes së 'letrarishtes' shqipe nga shovinistët serbomëdhenj është bërë në kuadër të sulmit frontal, antishqiptar të qeverisë së Beogradit, pas demonstratave të marsit e prillit. Udhëheqja e Beogradit është bërë 'pikë e helm', mes të tjerash, edhe për një arsye, se "pse u lejua (!) unifikimi i shqipes, përkatësisht pse u lejuan shqiptarët në Jugosllavi ta zbatonin gjuhën letrare gjithëshqiptare".

Gjithçka e ardhur nga Shqipëria duhej shembur. Plaku Tito, një politikan i regjur e dinak, ka vdekur. Si njeri i luftës, ai ishte i shkollës së Çurçullit, të cilit i dërgoi pranë djalin e tij. Ai kishte për qëllim të kombinonte shtypjen nacionale me idenë e progresit; ai nuk donte as një luftë krejt të hapur, e as vrasje krejt të mbyllura. Ai donte një turmë të destinuar që të shtypej dhe këto ishin shqiptarët, por edhe një masë aforme të gatshme për të vrarë, dhe këto ishin serbët. Ai donte të përdorte policin serb, por të vendosur nën kontrollin e oficerit jugosllav. Kur ai vdiq, e gjitha po kthehej në një shoshë. Kosova ishte hapja më e madhe dhe derdhja e idesë së tij të një bashkëjetese, ku vrasësi shpërblehej dhe i vrari dënohej, me kusht që i pari të jetë nga njëra prej 6 republikave jugosllave dhe, tjetri-i vrari- nga një krahinë, si ajo e Kosovës.

Në vitin 1981, ata që ishin pas tij vrapuan të drejtonin gishtin nga shteti shqiptar, duke ditur gjysmë të vërtetat dhe duke e kthyer gjithçka në një luftë të qëndrueshme dhe të përhapur në të gjitha viset. Vuajtja, i ka edhe ajo disa virtyteve.

Kosova është një rebele e vjetër. Sa herë që kishte ngritur krye në shekujt e fundit, e kishte pasur me të drejtë, e nëse deri atëherë të gjitha kryengritjet kishin qenë me fryte të përkohshme, kjo e vitit 1981 kishte pasur në vete farën e vizioneve të ardhshme.

Azem Shkreli, poeti i njohur, që në vitin 1972, pra në mesoren e viteve pas protestave të vitit 1968 dhe kryengritjes së vitit 1981, i tregonte si vëllait të tij, Kadaresë: Kur isha i vogël, ngaqë familja ishte e varfër, pasi dilja nga shkolla, im atë më çonte të kullosja një lopë. Shpesh mbetesha vetëm me lopën në ndonjë faqe kodrine të butë. Vështroja përreth: asnjëri. Atëherë mendoja se ishte koha të bëja një gjë të ndaluar, një gjë tepër të dënueshme, diçka që ia kalonte mëkatit.

Ajo gjë e ndaluar, ai mëkat i dënueshëm ishte kthimi i kokës nga ai drejtim ku mendoja se ishin malet e Shqipërisë. Ti habitesh? Të duket me siguri një frikë e tepruar. Dhe në këtë rast ashtu është vërtet: një frikë e tepruar nga fantazia fëmijërore. Por, në thelb, ajo bazohej në një të vërtetë të madhe. Ishim aq shumë të tmerruar nga ato që kishim dëgjuar, nga vrasjet e fshehta, torturat, spiunët që gëlonin ngado, saqë mjaftonte që edhe kthimi i kokës nga drejtimi i tokës ku duhej të ishte vendi amë, do të përgjohej nga dikush, do të kallëzohej, do të shkaktonte tmerr.

Askush nuk e di me siguri se ku dhe nga kush filloi nata e parë e demonstratave të marsit 1981 në Kosovë, të cilat përmbytën rendin e gjërave.

Në dhjetëra biseda që kam pasur me protagonistë apo pjesëmarrës të natës së parë të protestës, pra në çastin kur po thyhej 11 marsi, gjithherë kam shënuar diçka të re, e cila, edhe pse nuk ndryshonte shumë nga të tjerat, përsëri kishte diçka që nuk e kisha takuar diku tjetër.

Është një enigmë e përhapur në disa variante dhe, gjithsecili prej tyre ka një fillesë: nuk kishte asnjë lidhje me kërkesat e zakonshme studentore të cilat u dëgjuan natën e parë dhe, po ashtu, si nuk ishin të organizuar nga jashtë, nuk ishin edhe aq spontane sa dukeshin.

Ndoshta, e gjithë kjo, pasi kishte pasur disa qendra njëherësh, të cilat ishin bashkuar më pas dhe, kur gjërat kishin nisur të qetësoheshin, njerëzit e kishin parë se kishte pasur disa burime njëherësh, dhe, si të tilla, edhe disa fillesa.

Dikush kishte përplasur i pari duart mbi tavolinë dhe kishte bërtitur: "Mjaft më! Çfarë është e tepërt, është e tepërt", dhe në kohën kur të rinjtë studentë kishin nisur të mbushnin sheshin kryesor në mjediset universitare, kishte parë se edhe përreth kishte nisur e njëjta lëvizje.

➤



Kadare kishte shkruar më pas, disa muaj më pas, se këto të rinj ishin ngritur për republikën e tyre dhe ishin shtypur si në monarki,por shtypja kishte qenë edhe më herët e pranishme, e pushtetshme dhe e dhunshme, si çdo gjë që vendoset përmes armës.
Po Shqipëria?

***

## O perëndi, mos e ndotni botën e ëndrrave të vitit 1981 me dallaveret e kohës! / *Ukshin Hoti*



Në mëngjesin e 5 prillit 1981, në tryezën e punës së Enver Hoxhës, në selinë masive të Komitetit Qendror, sekretari i tij i përhershëm, Haxhi Kroi vendosi dokumentet e ditës, ata që vinin zakonisht nga të gjitha institucionet kryesore dhe, në të majtë, lajmet speciale të Agjencisë Telegrafike Shqiptare, të cilat shkurt quheshin 'agjancat'.
Këto të fundit përmbanin lajme që nuk ishin për publikun e gjerë. Si një ritual sekret, ata, ndoshta më shumë se gjithçka tjetër, tregonin afërsinë e njerëzve me pushtetin. Nuk ishin të gjitha njëlloj: ata kishin veçantinë e tyre për nivele të ndryshme. Sa më i detajuar të ishte Buletini i Lajmeve të ATSh-së që merrje, aq më i besuar do të ishe dhe aq më e lartë ishte pozita jote. Për anëtarët e Byrosë Politike dhe sekretarët e KQ materiali ishte më i plotë, më i detajuar; aty jepeshin edhe artikuj apo relacione që ishin jo dashamirës ndaj shtetit shqiptar, për të mos thënë, se e denigronin atë apo thjeshtë dëshmonin disa të vërteta, të ditura, por të ndaluara për t'u ditur. Çasti, kur buletini vinte e shkurtohej ishte i njëkohshëm me çastin e rënies tënde. Kur Buletini ndalohej, atëherë kishe rënë, pritej vetëm fundi.
Sekretari personal, i heshtur si gjithnjë dhe i përpiktë në gjithçka, kishte shënuar me një ngjyrë të kuqërremtë, të gjitha lajmet e agjencive më të njohura të botës për ngjarjet në Kosovë. Në fakt, ngjyra e vendosur në letër, dukej si vijëz gjaku.
Sapo ishte larguar Sekretari i Komitetit Qendror për Propagandën, që befas, në vitet e fundit, sidomos pas vdekjes së beftë të Hysni Kapos, ishte bërë i përhershëm në zyrën e shefit të madh. I qetë në pamjen e tij, me jakën e bardhë të këmishës vendosur zakonisht mbi jakën e xhaketës dhe folës i kujdesshëm, duke i zgjedhur fjalët me kujdesin e natyrshëm të njeriut që e di se nga fjalët mund të vinte e keqja më e madhe,i cili,jo shumë kohë më parë, kishte kaluar nëpër kalvarin e vitit 1974, kur shefi i qeverisë kishte kërkuar haptas kokën e tij, dhe ai i kishte dhënë ato të dy miqve të vjetër, Paçramit dhe Lubonjës.
Ai i kishte thënë sekretarit personal të Enver Hoxhës që ditarin e ditës ta linte të hapur, pikërisht aty ku ishin faqet e nënvizuara.
- Çfarë do të bëjmë për Kosovën?, - e kishte pyetur tri net më parë Enver Hoxha, kur befas, në pragun e mesnatës së dy prillit, e kishte thirrur me urgjencë në vilën e tij.
Ai e kishte ditur përse e kishte thirrur. Nga brenda vilës telefonata lajmëruese ishte bërë nga gruaja e shefit të madh dhe i kishte treguar se çfarë mund të bisedohej.
Megjithatë, Ramiz Alia, që e kishte njohur Kosovën kur kishte qenë atje gjatë luftës, si komisari më i ri i një divizioni partizan, në fillim kishte heshtur. Nuk kishte qenë më në Kosovë. Shumë vite e ndanin atë prej ditëve të luftës e, megjithatë, ajo që kishte ndodhur kishte qenë e beftë, e vrullshme, e pazakontë dhe, si duket, askush tjetër, veç atij që e kishte thirrur, nuk e dinte se cili kishte qenë fillimi i saj. As kryeministri nuk e kishte ditur. Kur e kuptoi se heshtja e gjatë do i kthehej pas dhe se,megjithëse i përkëdhelur, mund të ndeshej në zemërimin e shefit, i tha se duhej përballuar gjithçka përmes institucioneve dhe figurave të shquara.
Tjetri përballë, ulur në karrigen e lartë, duke shikuar nga dritaret e mëdha që binin nga rruga kryesore e Bulevardit të Madh, i kishte thënë se kjo nuk ishte e mjaftueshme. Ai ishte i pari që e kishte kapur momentin për të kthyer vëmendjen e shtetit ndaj një ngjarje që do e bënte të harronte hallet e brendshme dhe do të rriste mbështetjen.
- Jo, - i tha ai, - nuk do të bëjmë lojë lapanjozësh. Do të dalim hapur. Të tjerët do të vijnë pas nesh. Do ia nisim nga heroikja për të shkuar drejt të drejtës historike. Do të jemi epikë për të na kuptuar. Nuk do të ketë gjysma. Asnjë gjysmë, sado të bashkohet me një tjetër, nuk përbën të tërën. Ne do u japim të tërën, gjithë shtetin, gjithë mekanizmin tonë.
Pastaj ai i ra ziles dhe i tha shkurt sekretarit të tij: "Më thirr kryemnistrin. Të vijë menjëherë!". Kur Sekretari i Propagandës deshi të largohej, ai i bëri shenjë me dorë të rrinte dhe i drejtoi disa letra të bardha, ku, me germa të mëdha, ishin shkruar disa teza për një artikull të mundshëm.
- Shikoji njëherë. Unë do të dal me një artikull. Të fillojë nga maja.
Sekretarit i bëri përshtypje titulli, "Përse u përdor dhuna dhe tanket policore në Kosovë?"
Mjaftonte vetëm kjo. Lufta po rindizej. Do të ishte e gjatë, e dhimbshme dhe, si herë të tjera, do të kërkonte kurbanin e saj edhe në Shqipëri.
Cili do të ishte? Ai vetë, megjithëse i lindur në Shkodër, ku familja e tij kishte disa breza, për më tepër në të njëjtën banesë ku dikur kishte lindur edhe Oso Kuka, kishte origjinë boshnjake. Të ishte ai kurbani i së ardhmes? Për më tepër këmba e tij kishte shkelur në Jugosllavi dhe shefi i madh ishte tejet 'alergjik' ndaj gjithçkaje që kishte lidhje me atë vend. Që nga viti 1948, pas Plenumit të Tetë, të cilin, më pas, vetë ai e kishte quajtur 'Plenumi i Zi', dhe pas revizionimit të tij ishin dënuar disa nga përçuesit e Plenumit, që, ose kishin pasur lidhje të forta me Mugoshën, edhe atë Dushan, ose kishin një fill origjine vllahe, ose ishin treguar më entuziastë se duhet kur kishim qenë gjysmë vëllezër me jugosllavët, alergjia e shefit ishte rritur përbindshëm.
Për derisa, veç tij, ishte thirrur edhe shefi i qeverisë, i njohur si mik i afërt i Mugoshës gjatë luftës, të cilit i kishte shkruar një letër pasionante kur Dushani ishte larguar, pasuar nga një e tillë edhe prej gruas së kryeministrit, atëherë kurbani do të ishte njëri prej tyre.
Të tjerë nuk kishte. Gjysma e anëtarëve të Byrosë Politike ishin nën tokë, gjysma tjetër ishte përzgjedhur nga vetë ai, duke pritur pikërisht këtë ditë, kur shefi i madh do të zgjidhte kurbanin e radhës.
Rregulloi jakën e xhaketës dhe qeshi lehtas me vete. Gjithnjë, njeriu që kupton i pari idenë e kurbanit, ka më shumë kohë për të përgatitur kundërgoditjen e tij. Do të priste deri në ditën kur, tjetri që po vinte, pasionant dhe shpërthyes, do të bënte gabimin e tij, dhe ai, ashtu qetësisht, gjithnjë bartës i enigmës, do të përkujdesej që të merrte rrokopujën, nga e cila nuk do të kthehej kurrë më.
Nuk i kishte pëlqyer kurrë të ishte shenjtor, e aq më pak kurban.

***

Shumë vite më vonë, në shtatorin e vitit 1992, kur e kam takuar për herë të parë dhe të fundit, Ramiz Alinë, në një takim disa orësh, që kishte vetëm një ndërprerje, ardhjen e Frederik Reshpjes, dhe vetë ai ishte në arrest shtëpiak, nuk e di se si ra fjala për ngjarjet e vitit 1981. Unë kisha bërë një shkrim për idenë e Berishës rreth bashkimit kombëtar dhe hyrjes së Shqipërisë në Paktin e Helsinkut, që përjashtonin njëra tjetrën, të paktën në atë kohë, dhe e pyeta nëse qeveria shqiptare e kishte ditur se çfarë do të ndodhte në marsin e vitit 1981.
Përgjigja e tij më është dukur gjithnjë e sinqertë.
- Jo, - tha ai, - për ne, anëtarët e Byrosë, ishte e befasishme. Askush nga ne nuk e priste që të ndodhte. Në të gjithë Kosovën, - shtoi ai, - sipas burimeve që kishim, ideja e Republikës kishte epërsi, kjo nuk kishte asnjë dyshim. Por cila republikë? Shqipëria ishte më shumë për një shtet të dytë në Ballkan, se sa për bashkimin në një shtet.
- Po Enver Hoxha e dinte se çfarë do të ndodhte?
- Nuk e di, - tha ai. - Por është e mundshme, sepse vetëm ai nuk u befasua. Dukej se e priste. Kur ndodhën lëvizjet e 11 marsit, ai tha të mos ngutemi për të marrë në mbrojtje ndodhitë. Është ende, tha ai, një lëvizje për kushtet e jetesës, të presim deri sa të kthehet në lëvizje politike. Dhe ai priti.
- Prandaj Shqipëria u vonua në përgjigjen e saj? - e pyeta, sepse kjo ishte dëgjuar menjëherë pas janarit të vitit 1991, sa herë që përmendej kryengritja në Kosovë.
- Nuk jemi vonuar, - më tha ai. - Jemi matur e kemi pritur. Demonstratat me karakter politik ndodhën më 26 mars, kur, për herë të parë, u artikuluan kërkesa politike. Më 1 dhe 2 prill ndodhën përleshjet e mëdha. Pak ditë më pas, ne ndezëm të gjitha makineritë. Për disa nga ne ishte e panjohur se kush qëndronte pas këtyre grupimeve dhe lëvizjeve, cilat ishin synimet dhe kush printe, deri kur erdhën informacionet e plota. Nuk ishte kohë e gjatë, sidomos po ta mendosh se kufiri ishte i mbyllur.
Unë u ktheva përsëri tek Enver Hoxha dhe e pyeta, edhe një herë, nëse ai kishte ditur më shumë se gjithë të tjerët.
- Po, - tha ai, - Enveri dinte më shumë se të gjithë ne.
- Rënia e Mehmet Shehut a kishte lidhje me Kosovën?
- Jo, - shtoi ftohtë ai dhe shkëlqimi humbi nga sytë e tij.
**(Vijon)**



Shkruan: Adil BEHRAMAJ

# PRITJET E QYTETAREVE SI OPOZITË E KURTIT

Fitorja e SYRIZA-s, partisë së majtë radikale simotër të Vetëvendosjes, ishte historike për grekët në vitin 2015-të. Ajo i dha fund qeverisjes së gjatë të dy partive në Greqi. SYRIZA, deri atëherë një parti e vogël, arriti të bëhej zëri i grekëve që nuk i përballonin dot masat shtrënguese evropiane dhe t'i frymëzonte ata, duke marrë shumicën e votave.

Ishte hera e parë në historinë greke që një parti e së majtës radikale erdhi në pushtet.

Sikurse populli ynë, njëjtë edhe grekët prireshin kah populizmi dhe kjo ishte një prej arsyeve që çoi në ndryshimin drastik të mjedisit politik. Shoqëria greke ndjehej e ndëshkuar padrejtësisht nga kreditorët evropianë, sidomos nga Gjermania. Njëjtë siç ndjehet edhe shoqëria kosovare, e cila vazhdon të mbetet më e mashtruara dhe më e izoluara në Ballkanin Perëndimor.

Si modeli i tij grek, Alexis Tsipras, që kishte sjellje të ngjashme radikale opozitare, me retorika mikse populiste edhe Albin Kurti arriti të bëhej zëri i të pakënaqurve në Kosovë.

Zgjedhjet e 14 shkurtit ishin të qarta për të gjithë: Lëvizja Vetëvendosje e gëzon momentumin politik!

Fitorja e saj i dha fund njëherësh edhe ciklit të poshtër të bllokadave politike, pjesë e të cilave ishte edhe vetë Lëvizja Vetëvendosje, që nga viti 2014-të. Për herë të parë pritet të mos ketë vonesa në krijimin e institucioneve të reja, veçanërisht zgjedhjes problematike të presidentit, duke shpresuar në kulturën institucionale të opozitës së re.

Sa do ta gëzojë Lëvizja Vetëvendosje këtë momentum politik dhe sa gjatë do të dominojë në skenën politike, varet shumë nga puna e saj dhe nga angazhimi i opozitës së re. Por, kështu siç është, opozita aktuale do të jetë një kafshatë e lehtë për Kurtin. Ai më i rrezikuar është nga vetvetja, nga mungesa e përvojës institucionale, bindjet dhe ngarkesa e tij ideologjike e politike, se nga kjo opozitë.

Kur grekët votuan për Tsipras, ata nuk prisnin që ai t'i mbante të gjitha premtimet, por zgjodhën t'ia jepnin një shans atij. As kosovarët nuk presin që Kurti t'i mbajë të gjitha premtimet, por zgjodhën t'ia jepnin shansin.

Në anën tjetër, ky është një shans edhe për partitë opozitare, por për të reflektuar, riorganizuar dhe reformuar.

Zgjedhjet rezultuan të ishin nevralgjike për të gjitha subjektet tjera politike, të cilat nëse nuk reformohen shpejt mund të kolapsojnë dhe të mos arrijnë të ringrihen, duke imponuar kështu riorganizim të të rinjve dhe të pakënaqurve në ndonjë iniciativë të re politike.

Një shpresë e re, veçanërisht për LDK-në, mund të jetë edhe Lumir Abdixhiku me kandidaturën e tij. Zgjedhja e tij në krye të LDK-së, përveç që mund ta ndryshojë trendin e rënies, do të ishte një presion pozitiv edhe për PDK-në, e cila gjithsesi që duhet të reformohet për të qenë më konkurruese në zgjedhjet e radhës.

Me këto kompozime politike, siç aktualisht janë këto parti tradicionale, nuk do të mund t'i ruajnë dhe mirëmbajnë as pozicionet aktuale. Shumë figura të tyre, që politikës i marrin me dekada pa i dhënë asgjë, nëse sadopak ua duan të mirën partive të tyre është koha të lëshojnë rrugë.

Fatmirësisht, kontrastet politike kanë rënë dhe elektorati politik tashmë është shumë më i vetëdijshëm dhe më i lëvizshëm se asnjëherë më parë. Prandaj, sot, përtej taborëve politikë, duhet të vlerësohet kushdo që punon dhe i shtynë përpara proceset shtetërore e shoqërore.

Personalisht, jam shumë skeptik në rezultatet që mund të ketë qeveria e re. E joshur nga privilegjet dhe mundësitë e pushtetit, deri sa të futet në ciklin e degjenerimit publik, pres vetëm ndonjë spektakël politik dhe kapje masive të institucioneve publike prej saj. Por, dëshirë e çdo qytetari të përgjegjshëm është që qeveria e vendit të ketë suksese, sepse të arriturat e saj janë edhe suksese të shtetit. Megjithatë, nisur nga fakti që Kurti si majtist është ndër të rrallët në botë që deri para disa muajsh i preferonte vetëm trotuaret dhe transportin publik, kurse tash po i preferon xhipat e zi dhe eskortën, sigurisht se lë shumë për të dëshiruar.

Kur partitë i marrin përgjigjet e qytetarëve nga kutitë e votimit, ato duhet të dinë t'i lexojnë e kuptojnë. Prandaj, rezultatet e tashme zgjedhore e kanë ndryshuar tërësisht edhe kursin e politikës, brenda dhe jashtë. Këto rezultate, po ashtu, me kokëfortësi kërkojnë gjenerata dhe vlera të reja në tregun politik.

Është e natyrshme që para zgjedhjeve ka fjalime elektorale. Por, pas tyre ka vetëm realitete shoqërore. Realiteti i ri i dalë nga zgjedhjet e 14 shkurtit kërkon një kurs të ndryshëm prej qeverive paraardhëse. Dialogu, i cili ishte temë këto ditë, nuk meriton të jetë as prioritet i katërt, as i shtatë. Madje, as i njëzet. Por, qeverisë do i duhet të merret me çdo çështje të hapur, pa e pasur komoditetin e zgjedhjes së tyre. As qeveritë e kaluara nuk do të merreshin me dialogun, sikur ta kishin komoditetin e zgjedhjes, por ky proces ka qenë i imponuar dhe do t'i imponohet edhe qeverisë së re.

Po të pyetej Kurti, ai me kënaqësi ende do të peshkonte elektorat dhe do të merrej me populizëm, por ndonëse nuk po duket aspak i lumtur si fitues, tani i duhet të merret me problemet e përditshme të qytetarëve dhe me zbatimin e programit qeverisës, të cilin ende nuk e ka.

Kurti është zgjedhur që ta drejtojë vendin në këtë periudhë kohore, por i mbetet atij të vendosë nëse do të jetë kryeministër apo kalimtar i radhës nëpër qeveri. Me një kabinet plot narcisistë, sikurse ai i kaluari, që më shumë shpërfaqnin injorancë të kombinuar me vetëbesim, se përgjegjshmëri, maturi dhe profesionalizëm, sigurisht se vetëm kalimtar mund të jetë. Në këtë mënyrë, si ish-kryeministër, veç fotografia mund t'i mbetet si gjurmë në ndonjë cep të institucionit, jo më shumë.

"Të rriturit në dhomë" është filmi që dramatizon më së miri rastin e SYRIZA-s në Greqinë e fundosur prej borxheve. Pas ndërprerjes së bashkëpunimit me Trojkën, që ishin Komisioni Evropian, Banka Qendrore Evropiane dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, teksa kryeministri Alexis Tsipras lëvizë me veturë së bashku me ministrin e preferuar të grekëve, Yanis Varoufakis, në një sekuencë të filmit bëjnë një dialog shumë të bukur. Pasi u hidhet mbi veturë një turmë e grekëve të entuziazmuar, Yanis i thotë Tsiprasit: "Ata janë fuqia jonë". Ndërsa, ai ia kthen: "Ata mund të na kthehen kundër nesër". "Nëse ne i zhgënjejmë apo tradhtojmë ata", vazhdon dialogun Yanis, i cili më pas merr kundërpërgjigjen e Tsiprasit: "Një ditë do të zhgënjehemi edhe ne". Ministri Yanis Varoufakis, që në xhep mbante gjatë gjithë kohës letrën e dorëheqjes, plotësisht i bindur ia kthen: "Nuk ka për të ndodhur!".

Pas 5 muaj e 12 ditë, Yanis i ishte kthyer gruas së tij në shtëpi si i dorëhequr. Ndërsa, lideri i SYRIZA-s, i humbi zgjedhjet pas katër vjet qeverisjeje.

Aktualisht, Albin Kurti e ka besimin e popullit. Përkohësisht, kaq edhe mund t'i mjaftojë atij. Por, për fatin e tij të keq, popullit nuk i mjafton. Populli kërkon vazhdimisht rezultate. Publikisht apo privatisht, çdo qytetar bën rekapitulime sa i është përmirësuar jeta me ndryshimet e bëra, duke nisur që nga votimi ndryshe i tij.

Si kryeministër i ri, ai tash duhet t'i braktisë lojërat e tij opozitare dhe të qeverisë si i rritur, duke shpenzuar më pak kohë në kërkimin e frazave për impresionimin e qytetarëve dhe më shumë në hartimin e programit dhe politikave publike, sepse as program qeverisës nuk ka.

Programi i tij ka vetëm emër e mbiemër: Albin Kurti. Prapa nuk i vjen historia, por problemet e qytetarëve dhe të shtetit të Kosovës. Ndërsa, aty ku pritjet janë të mëdha, i madh mund të bëhet edhe zhgënjimi!

# SHTETET PERENDIMORE, NËSE JANË VERTET DEMOKRATIKE, NUK DUHET TË IMPONOJNË POLITIKA ANTISHQIPTARE E TË BËJNË EKSPERIMENTE ME SHQIPTARËT

## * PERENDIMI KA DETYRIME NDAJ KOMBIT SHQIPTAR, QË DUHET T'IA SHLYEJË PËRMES NDREQJES SË FAJEVE QË KA BËRË NË KURRIZ E NË DËM TË TIJ, HISTORIKISHT!



Isa FERIZAJ

Kosova sapo ka hyrë në vitin e katërmbëdhjetë të Mëvetësisë së saj, mëvetësi kjo e njohur nga mbi njëqind shtete të botës, në krye të të cilave qendrojnë shtetet më të fuqishme perendimore e evro-atlantikase. Ky fakt flet qartë për një njohje të një realiteti të ri gjeo – politik në Ballkanin e trazuar, jo nga vetvetja, por nga përzierjet e 'më të mëdhenjve' në hesapet e vendeve të këtij rajoni më se evropjan. E tërë historia ballkanase e passhkëputjes nga Perandoria Osmane, është historia e përplasjeve të mëdha të interesave të 'fuqive të mëdha', interesa ato të bashkëlidhura me vasalët e tyre, me 'më të mëdhenjtë', apo 'me të përkëdhelurit' e tyre rajonal, nga fuqimëdhenjtë, në dëm e, në kurriz të popujve e kombeve të vegjel e të pambështetje ndërkombëtare.

Dihet historikisht se si shqiptarët u shkëputën të fundmët nga Perandoria Osmane, jo me deshirën e tyre, por për shkak të rrethanave historike të kohës, rrethana që imponoheshin nga pushtuesi shumështekullor Osman. Sllavët duke ndjekur historikisht një politikë antishqiptare, pothuajëse që me ardhjen e tyre në Ballkan ( aty nga shek. VI i erës së re) u zgjeruan shumë në hapësirat e tyre, në kurriz të trojeve shqiptare, politikë kjo që jeton edhe në ditët e sotme. Këtë fakt e njeh fare mirë historia, por edhe faktorët politik me peshë në kontinentin evropjan të asaj kohe, si edhe të të gjitha kohërave të mëpastajme.

Është për t'u habitur se me 'problemin shqiptar', apo me shqiptarët e trojet e tyre, si në kohën e gati dy shekujve më parë e, në vijimësi, ende kjo Evropë, nuk ka gjetur mendësinë e duhur, as gjykimin e drejtë, por as veprimet e duhura njerëzore ndaj shqiptarëve në trojet e tyre etniko-natyrore në Ballkan. Si para afër dy shekujve, ende kjo Evropa e sotme, në formë e re, por në thelbin e saj, antishqiptare, e vjeter sa më s'ka, harxhon kaq shumë kohëra të çmuara duhe thirrur konferenca pas konferencave boshe e bajate, gjoja për të zgjidhur problemin shqiptar në Ballkan, a thua se shqiptarët na qënkan historikisht 'delja e zezë' në bashkësinë e kombeve në rajon.(!!) Kaq shumë bisedime pas bisedimeve; kaq shumë takime pas takimeve, pa asnjë rezultat; kaq shumë fallsopropogandë e shurdhshmëri në veshët e Evropës bashkëkohore ndaj çështjes shqiptare!

Sa herë kombi ynë ka ngritur krye për të drejtat e tij të mohuara nga pushtuesi historik e shekullor, por edhe të nëpërkëmbura nga faktorët ndërkombëtarë, kryesisht evropjanë, sistematikisht, me qellime e synime të caktuara, gjithnjë antishqiptare, mbështetja e kësaj Evrope ka qënë sistematike e në trajtë të pashkëputur në krah të ish – shtetit pushtues të Jugosllavisë së krajlëve, por edhe të asaj 'të resë' me shpirt të vjetër.

Traktatet e dala në vijimësi nga vendimet e kancelarive evropjane kanë qënë me karakter të thellë e të mirëdukshëm antishqiptar. I merrni me radhë të gjitha vendimet e të gjitha takimeve e 'bisedimeve' për shqiptarët, zhvilluar e marrur nga Evropa e, dukshëm do ta vereni këtë qendrim, pse jo edhe rracist ndaj shqiptarëve. Kjo dukuri aspak njerëzore, se e drejtë, jo se jo, kuptohet fare lehtë nga faktorët e marrjes së atyre vendimeve, por është e çuditshme se si edhe në këtë shekullin e ri, XXI, ky qendrim nuk ka ndryshuar aspak, por këta faktorë vendimmarrës evropjanë, në mënyra të kamufluara e të sheqerosura, ende ushqejnë aso lloj ndjenjash e veprimesh antishqiptare, si në kohërat e errëta mendore të Evropës imperialiste.

Sot, paradoksalisht e çnjerëzizht, nga fuqitë e mëdha të Evropës, shqiptarëve iu vihen kufij, iu vihen pengesa, iu vihen kushte pas kushteve, iu kerkohen aso lloj normash ligjore sa edhe vet kjo Evropë nuk i ka ende, i kufizojnë në lëvizjen e lirë jashtë atdheut; iu kërkojnë të ngrejnë "Gjykatë Speciale" për gjykimin e shqiptarëve luftëtarë të UÇK-së e, të shkojnë e të vetëdorëzohen në tribunale 'drejtësie' ndërkombëtare, të paditur nga kjo Evropë, për t'u gjykuar si kriminelë lufte; iu kerkohet që brenda teritorit të tyre, pra në Kosovë, të lejojnë pakicën serbe, pra vetem atë serbe, që të krijojnë modelin e 'srbska republika' në Bosnje; iu kerkojnë që të japing teritore nga teritori i tyre shtetror, Malit të Zi, në këmbim të heqjes së vizave për lëvizje të lirë në Evropë, por që kurrë s'e zbatuan edhe pse shqiptarët plotësuan kerkesën e evropjanëve kushtvënës edhe pse në dëm të tyre; iu kërkohet që të diskutojnë me serbët nga pozitat e 'humbësit' të luftës së viteve 1998 – 1999 kur e tërë bota e njeh popullin shqiptar në Kosovë si viktimen dhe fitimtarin e asaj lufte!? U kerkojnë shqiptarëve që të bëjnë, në raport me serbët, 'korigjim kufijsh' në dobi të Serbisë, si kusht për të pranuar serbët të njohin mëvetësinë e Kosovës, ndonëse kufijtë e shqiptarëve kudo, kalojnë nëpër troje shqiptare. Nuk ndodhi që as Europa e vjeter e pasmbarimit të LDB të ngrejë "Gjykata Speciale" për viktimat e asaj lufte, por çoi para drejtësisë së gjykatës në Nyremburg, të gjithë kriminelët e gjallë të LDB nga radhët e kampit aggresor nazi-fashist.

Sot, pas 75 vjetëve nga përfundimi i LDB, me shqiptarët e Kosovës po ndodh e kundërta e asaj që ndodhi në gjykatën e Nyrembergut.(??!!) Fakti i ngritjes së një "Gjykate Speciale" për të gjykuar viktimat e një lufte të drejtë çlirimtare të një populli nën pushtim, është një rast unikal e eksperimental në këtë botën e sotme 'demokratike'.

Eksperimentet ndër shqiptarë s'kanë të sosur! Shqiptarëve në Kosovë iu kerkojnë të ndërrojnë flamur e hymn kombëtar; duke iu cenuar e nëpërkëmbur nderin e dinjitetin e tyre kombëtar; iu kerkojnë që serbët të përfaqësohen në Kuvendin e Kosovës, vetem me një listë të pavotuar e, me një numër të caktuar 'deputetësh' të pavotuar, çka s'bën vaki në asnjë vend me vlera të verteta demokratike, në këtë botë.

Kjo dukuri nuk ndodh as në kryekështjellën botërore, në SHBA-në e demokracisë së këtij sistemi. Iu kërkohet shqiptarëve që të eksperimentojnë mbi tri vjet me reformën në drejtësi, duke e lënë vendin pa pushtetin e gjyqësorit e, populin pa dhënien e drejtësisë së shumëdeshiruar, siç s'ka ndodhur kund tjetër në botë!?

Shtetit të pavarur shqiptar të Kosovës ia kanë ndaluar me 'urdhër' nga më të mëdhenjtë, që të formojnë ushtrinë e Kosovës. Njëra nga detyrat e para të çdo shteti të ngritur historikisht mbi këtë planet, ka qënë dhe mbetet krijimi i ushtrisë së atij shteti. Sot, pas 13 vitesh mëvetësi, shteti i Kosovës nuk lejohet të krijojë ushtrinë e vet, me natyrën e përmbajtjen që ka çdo ushtri e çdo shteti në botë, sipas veçorive përkatëse.

Përseri, në vazhdën e eksperimentalizmave absurd, për shqiptarët prodhohen aso lloj politikash që i orientojnë ata që të vetmohojnë të kaluarën e tyrë të lavdishme, të mos i zënë me gojë faqet e lavdishme të historisë kombëtare, as ngjarjet e mbuluara me lavdi, as heronjtë e tyre, as figurat e shquara kombëtare historike, as arritjet e paranëntëdhjetës, nga asnjë fushë. Atyre, përkundrazi iu injektohet urrejtja për lavdinë dhe lavdimëdhenjtë e historisë së tyre dhe, pranimi i nihilizmit, i përuljes ndaj bashkëpunëtorëve të pushtuesve nazi-fashistë në LDB, për të arritur deri tek reabilitimi i tyre, siç edhe ka ndodhur, por edhe të tradhtarëve të njohur botërisht edhe me dokumenta ndërkombëtare të pakontestueshëm, si Ahmet Zogu, Esat pashë Toptani, Mit'hat Frashëri etj. (!!)

Si shpjegohet që edhe pas 23 viteve të rënies heroiko – legjendare të kryekomandantit legjendar të UÇK e të LÇK, Adem Jashari, në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë, ende nuk ka një shtatore kushtuar këtij heroi me përmasa kombëtare?! Po kështu ka ndodhur edhe me vlerësimin e nderimin e atdhetarit e intelektualit të përmasave jashtëkombëtare, Ukshin Hoti. E, krejt paradoksalisht, ngrihen përmendore për Ibrahim Rugovën dhe organizohen ceremoni zyrtare me protokoll shtetëror pranë varrit të tij. Ku Adem Jashari e Ukshin Hoti, vrarë e zhdukur nga regjimi fashist milloshevicjan e, ku Ibrahim Rugoba pacifist e mosnjohës i UÇK, i mbrojtur në vitet e LÇK direkt nga milicia e Sllobodan Milloshevicit. (!!)

Shqiptarët, vertet dolën të fundit nga pushtimi Osman, por në rrugëtimin e tyre, herë rrëzohu e, herë ngrihu, kanë treguar se dinë të bëjnë shtet e, bile shtet nga më të konsoliduarit e, nga me të pathyeshmit në rajon dhe në Evropë, në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar. Këtë fakt e njeh shumë mirë historia moderne, por edhe kjo Evropë shpirtplakur, pse jo edhe zemerkalbur.

Tellallët politikë të shteteve evropjane janë sterlodhur duke thirrur e mbrojtur gjoja 'demokracinë' në vendet e tyre. Kancelaritë e kësaj Evrope janë tejlodhur duke hartuar 'receta' e gatuar 'çorbë' pas 'çorbe të prishur' për t'ua shitur shqiptarëve si 'demokraci'!

Shtetet e verteta demokratike, demokracinë e kanë zemren e trurin e tyre e, me atë nuk lejojnë askënd që ta keqpërdori. Aleancat e më 'të vegjëlve', si bie fjala, e ne shqiptarëve' me më 'të mëdhenjtë' dhe me më 'të fuqishmit', konceptohen e lidhen mbi thelbin e demokracisë e, jo si pushtime (kundërrevolucione) 'të kadifenjta', apo si 'pranvera' Prage.

Rrënimi i vendit, i ekonomisë dhe vjedhja e grabitja e pasurive kombëtare nga huliganët politik, në vendin

tonë, pas vitit 1990, nuk u bë fshehurazi kësaj Evrope, por mu në sytë e nën hundën e saj. Përse nuk e ndaloi kjo fuqi e madhe demokratike, frymën shkatërimtare e vrastare në një vend kaq të vogël sa ky i yni?
Gjithkush, me kulturën më të pakët demokratike në botë e din se çfarë funksioni ka një 'X' ambasador në një vend, por as ai me kulturën më të bollshme demokratike, s'e kupton se si ai "X" ambasador të bëhet edhe President, edhe kryeministër, edhe krytar Parlamenti, edhe ministër, edhe kryeprokuror, edhe kryegjyqtat i atij vendi. Kjo dukuri s'është aspak e tolerueshme e, aspak demokratike për asnjë vend apo shtet që i thotë vetes 'vend e shtet demokratik'! Ndodhin, paradokse të tilla e dukuri absurde jonormale tek ne, falë palopolitikave që pjellin palopolitikanët tanë të paaftë, servilë e të babëzitur marrësisht, por edhe antikombëtarë.
Vende të tilla demokratike, kryesisht ato perendimore, për këtë lloj sistemi ku jemi zhytur me dhunë edhe ne shqiptarët andej e këndej Drinit, miqësisht e me kulturë miqësore duhej e duhet të ndihmonin e të ndihmojnë shtetet si tonat, që të gjejnë shtegun natyrshëm për kah demokracia e, jo të na zhytin herë pas here në trazira, në kriza e në përplasje politike që na çojnë me dekada prapa, duke na lënë ne shqiptarëve si fajtorë e, përherë në zhagitje mjerane. Tashmë edhe fëmia, për nga progresi i zhvillimit natyror, është i ditur dhe e kupton ndihmën e vertetë nga ajo 'demokraci' që shitet si e tillë, por që fatkeqësisht njëjtësohet me 'bishtin e drdhës', për ne shqiptarët!
Vullneti e ëndrra shekullore e shqiptarëve, pasi nuk u zgjidh nga ata që e cenuan dhe e masakruan atë, duhet të zgjidhet nga vet shqiptarët, por edhe të pranohet nga ata që s'kanë kurajo ta ndreqin vet fajin e baballarëve të tyre politik, ndaj kombit e trojeve tona. Një qendrim i tillë quhet e njihet si qendrim i vertetë demokratik, ashtu siç ishte vendimi i Presidentit Klinton për bombardimin e ish-Jugosllavisë nga NATO-ja në vitin 1999. Edhe pse ai qendrim aso kohe fshihte brenda tij interesa madhore amerikane, ne e vlerësojmë si ndihmë njerëzore, morale e demokratike të një vendi të madh që edhe më parë ka mbrojtur kombin tonë nga synimet shoviniste e rraciste të fqinjve tanë e të aleatëve të tyre evropjanë.
Nga ç'lloj demokracie perendimore pjell parimi sygjerues për popullin tonë: "Bëni siç iu themi ne, por mos bëni çfarë bëjmë ne"! A nuk i ndanë dhe , a nuk i bashkuan teritoret në Evropë, pas vitit 1989, me rënien e 'Murit të Berlinit', siç deshën, këta evropjanët demokratë të mëdhenj? A nuk ekzistonte për ata vendimi i KSBE – OSBE, për mosndryshim kufijsh, në lidhje edhe me intresat e tyre? Po për ne shqiptarët, që s'e patëm nënshkruar as atë dokumentin final të asaj organizate aq 'të madhe' europerendimore me përmasa tejevropiane, deri në ndërrimin e sistemit, përse u dashka zbatuar me korrektësinë më të madhe, vetem ndaj nesh?! A nuk është kjo dukuri negative që vjen nga vendet 'demokratiko - perendimore', një dystandartësi në lidhje me të drejtat e shteteve e të kombeve, të drejta të njëjta kudo në botë?!
Përse, shqiptarëve në Kosovë ua kanë sanksionuar në dokumentat e formuluara nga ana e tyre, krejt me përmbajtje antidemokratike, që të mos flasin e, as të mos veprojnë në drejtim të ribashkimit kombëtar, një dukuri kjo krejt e natyrshme dhe njerëzore, e mbështetur në të gjitha dokumentet e marrëveshjeve dhe të marrëdhënieve të të drejtës ndërkombëtare, ko kombet kanë të drejtën e vetëvendosjes për fatin e tyre?!
Popujt dhe shtetet e tyre, në liri të plotë e, me vullnetin e shumicës së popullit, mbështetur në dokumenta themeltarë edhe ndërkombëtar në lidhje me të drejtat e njeriut, të kombeve e të shteteve, janë të prirur që të zgjedhin e të vendosin vet formën e shtetit, llojin e sistemit e drejtuesit e vet. Vendosja shabllone e sistemit dhe e zbatimit të politikave, sipas më të madhit, apo më të fortit, shkakton trauma sociale, prish balancat politike dhe fut shoqërinë njerëzore në qorrsokaqe e theqafje krizash, rrevoltash e luftrash të pashmangsme locale e rajonale, haraçet e të cilave i paguajnë popujt e vendet viktima të tyre.
Sot është koha që ne shqiptarët, pikësëpari, të shkundemi e të vetëdijësohemi se tradita më e mirë kombëtare shtetformuese, mbështetja e popullit në tërësi, shpërndarja e drejtë e pasurive kombëtare, zhdukja e thellimit të hendeqeve ekonomiko-socialë, punësimi e shkollimi i njerëzve, orientimi si komb drejt 'Yllit tonë Polar' – Ribashkimit Kombëtar, të vihen në planin e parë ndërveprues të të dyja shteteve shqiptare të sotme. Koha ikën dhe nesër ajo gjykon tradhtarët, që në fakt s'janë mitik, as folklorik, por më real se kurrë më parë.

Tiranë, më 11 mars 2021.

# Gjysmëreformat janë të rrezikshme sa gjysmanalfabetët!



Shkruan: Musli GUCATI

"Gjysmëreformat janë të rrezikshme sa gjysmanalfabetët sepse shkëlqejnë vetëm për t'i verbuar sytë e votuesve që s'marrin aq shumë vesh nga politika".
Analfabetët, në anën tjetër, i fusin hundët kudo dhe gjithkund dhe bëhen turistë në profesionet e huaja, të cilat jo vetëm që nuk i zotërojnë, por i bëjnë për spital, sepse ua humbin kuptimin dhe destinacionin.
Nuk po e vazhdoj më tutje rrëfimin rreth e rrotull, por po i bie shkurt e trup, sepse ndryshe s'ka kuptim.
Partia për të cilën rrah zemra ime me emrin PDK, nuk i ka humbur rastësisht zgjedhjet, por pikërisht pse e ka nënçmuar intelektin dhe sensin e votuesit për t'u thelluar në detaje dhe për të analizuar shumë më mirë sesa që kanë besuar disa kuadro në krye të hierarkisë partiake.
Fakti që një pjesë e madhe e popullit tonë të dashur jeton në mërgim, apo edhe më saktë në shtetet me demokraci, zhvillim dhe mirëqenie më të avancuar, ua jep atyre mundësinë e mësimit dhe krahasimit.
Apo edhe më saktë mundësinë e mësimit nga praktikat, rregullat dhe përvojat e partive simotra në Perëndim dhe krahasimin e tyre me partitë tona.
Dhe jo vetëm kaq, por edhe krahasimin e drejtpërdrejtë të mënyrës së politikëbërjes që praktikohet atje dhe të ne.
Dhe kjo mundësi ua hap mërgimtarëve tanë shqisat dhe horizontet për ta kuptuar se si funksionon politikëbërja e suksesshme, e dobishme dhe profesionale.
Në Perëndim çdo dështim paguhet me dorëheqje të parevokueshme të dështakëve që janë fajtorë për rezultatet katastrofale të partive që marrin pjesë në zgjedhje parlamentare.
Në Kosovë, përveç që nuk ndodh e një gjë e tillë, fajtorët jo vetëm mbesin të pandëshkuar, por pa asnjë gram të kritikës dhe vetëkritiks e vazhdojnë avazin.
Dallimi tjetër:
Në Perëndim individi futet në politikë për t'i realizuar interesat e mirëqenies së përgjithshme.
Në Kosovë ndodh e kundërta:
Individi futet në politikë për t'i realizuar interesat personale përmes kontributit për rrënimin e interesave të përgjithshme.
Çasti tjetër shqetësues:
Në Perëndim reformat fillojnë poshtë nëpër degë dhe mbarojnë lartë në krye të partisë.
Në Kosovë degët mbesin të paprekura ndërsa në krye të partisë ndërrohen vetëm disa emra dhe mbiemra, mirëpo thelbi i politikëbërjes mbetet i paprekur, prandaj edhe pasojat anësore vazhdojnë të jenë të njëjta.
E vazhdojnë të jenë të njëjta, sepse burimi i problemit mbetet i patrajtuar dhe i paizoluar. Dhe në këtë mënyrë vazhdon avazi i vjetër derisa të ndodhë një fiasko si ky që i ndodhi PDK-së në zgjedhjet e kaluara parlamentare.
Çështja tjetër është tjetërsimi i votave brenda llojit që në Kosovën tonë të dashur është shndërruar në sport dhe ka bërë shkollë.
Vota është dhe duhet të mbetet gjithmonë vendim i lirë i qytetarit dhe duhet respektuar nga çdo strukturë dhe jo të jetë në duart e komisionarëve dhe personave të papërgjegjshëm të cilët janë duke e dëmtuar Partinë Demokratike të Kosovës, kjo dukuri negative duhet të mos jetë prezent në zgjedhjet ardhshme.
Reformat që i ka filluar kryetari Kadri Veseli duhet të jetësohen dhe njerëzit të cilët janë duke ia shkaktuar humbjen PDK-së duhet t'ua lënë vendin njerëzve të përgatitur dhe profesional. Prandaj emrat dhe mbiemrat e njëjtë vazhdimisht riciklohen së bashku me mendësinë e tyre të prapambetur.

# 77 për qind e qytetarëve të Ballkanit Perëndimor thonë se marrëdhëniet në rajon janë më të mira se një vjet më parë

Sarajevë / Tiranë - "Muajt e fundit, që nga takimi ynë i tetorit, kanë qenë të vështirë me shpërthimin e valëve dhe varianteve të reja të virusit Covid-19 pasi po i kthejnë gjërat përmbys me një spirale zbritëse. Sa i takon bashkëpunimit rajonal, lajmi i mirë ishte suksesi i Samitit të Sofjes të Procesit të Berlinit dhe miratimi i Deklaratës për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe Planin e Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal (CRM), i cili nuk është i panjohur nga qytetarët pasi 77 për qind e tyre pajtohen se marrëdhëniet në Ballkanin Perëndimor janë më të mira se një vjet më parë, dhe kjo është një rritje e madhe krahasuar me shifrën 46 për qind të vitit të kaluar", ka thënë Majlinda Bregu, sekretareshë e Përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), në hapjen e takimit të 42-të të Bordit të RCC-së të mbajtur të enjten.
Ajo ka thënë se vënia në zbatim e CRM-së dhe arritja e rezultateve për Samitin e Berlinit janë përparësia jonë kryesore. "RCC-ja ka punuar me partnerët për ta përcaktuar dhe formësuar agjendën dhe do të përkushtohet maksimalisht për të koordinuar dhe monitoruar përparimin e politikave të çdo fushe. Qëllimi ynë është të arrijmë një zonë rajonale sa i takon tregtisë, investimeve, digjitalizimit, industrisë dhe inovacionit duke u mbështetur në suksesin e parimit të katër lirive të BE-së", ka thënë Bregu. Ajo i ka prezantuar bordit raportin mbi aktivitetet e Sekretariatit të RCC-së në periudhën tetor 2020-shkurt 2021, i cili u aprovua dhe ndau informacione mbi aktivitetet më të rëndësishme të Sekretariatit për periudhën në vijim.




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Drita rikthehet në pozitën e parë, Ballkani shkatërroi Arbërinë

Drita e mposhti Gjilanin në derbi dhe me tri pikët e marra rikthehet në krye të elitës. Fitore bindëse të enjten regjistroi edhe Ballkani në përballje me Arbërinë. Tash skuadra suharekase renditet e dyta në tabelë



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 MARS - Skuadra e Dritës e ka konfirmuar edhe një herë se nuk është rastësisht kampione në fuqi e Superligës së Kosovës në futboll. Kjo skuadër e fitoi të enjten me rezultat 2-0 derbin ndaj Gjilanit në kuadër të javës së 24-t. "Jam shumë i kënaqur me fitoren. Lojtarët e dhanë maksimumin. Jam i lumtur që asnjëherë nuk na rrezikoi kundërshtari, përveç një goditje nga largësia. Këtë fitore ua dedikojmë tifozëve 'Intelektualët' që gjithmonë janë afër nesh edhe pse nuk janë në stadium", ka thënë pas ndeshjes Ardian Nuhiu, trajner i Dritës.

Në minutën e 12-të Hamdi Namani realizoi për 1-0, kurse gjashtë minuta pa përfunduar pjesa e parë, Ardian Limani shtoi epërsinë e Dritës në 2-0. Në pjesën e dytë gola të tjerë nuk pati dhe Drita i mori pikët e plotë nga kjo ndeshje derbi. Drita rikthehet në krye të Superligës me 53 pikë, kurse Gjilani mbetet në pozitën e katërt me 33 pikë. Ndërsa ndeshja në mes të Arbërisë dhe Ballkanit ka qenë mjaft e hapur dhe interesante. Fituese doli skuadra e Ballkanit që realizoi gjashtë gola, kurse djelmoshat që drejtohen nga Arbnor Morina shënuan dy herë. Hoxha e hapi serinë e golave për 0-1, kurse në pjesën e parë për mysafirët realizoi edhe Daku. Ky i fundit në pjesën e dytë realizoi edhe dy gola të tjerë, ndërsa një tjetër e shtoi Gripshi. Për Arbërinë realizuan Kryeziu dhe Marceli nga penalltia. Pas javës së 24-t, Ballkani rikthehet në pozitën e dytë me 51 pikë, kurse Arbëria renditet e teta me 26 pikë të grumbulluara. Xhiroja e 25-t në Superligë do të jetë mjaft e zjarrtë, ku do të përballen dy skuadrat e para në tabelë, Ballkani dhe Drita. Suahrekasit do të përpiqen ta shfrytëzojnë terrenin vendor dhe ta mposhtin Dritën, në të njëjtën kohë të ngriten në pozitën e parë.

## Bylbyl Sokoli paralajmëron dorëheqje

Gjilani pësoi humbje nga Drita (2-0), kurse Bylbyl Sokoli pas ndeshjes ka paralajmëruar se mund të japë dorëheqje. "Profa" në postin e trajnerit të Gjilanit e kishte zëvendësuar Gentian Mezanin, i cili ishte larguar nga klubi gjilanas për mungesë të rezultateve pozitive. "Unë mendoj se me këtë angazhim nuk mund të fitohen ndeshjet. Duhet më tepër motiv, sakrificë, shumë angazhim për t'i arritur rezultatet. Prandaj duhet pasur kujdes se çfarë duhet ndërmarrë. Ishte fillim i plogësht i pjesës së parë. Megjithatë, kjo nuk tolerohet për një ekip që pretendon të jetë serioz në Superligë. Është gabim fakti të fillosh të luash vetëm pasi pranon dy gola. Me siguri se do të analizoj pozicionin tim në klub", ka thënë Sokoli.

**SUPERLIGA - Java e 24-t**

| | |
|---|---|
| Drita - Gjilani | 2-0 |
| Arbëria - Ballkani | 2-6 |
| Trepça'89 - Feronikeli | 0-0 |
| Llapi - Drenica | 3-3 |
| Prishtina - Besa | 5-1 |

**Tabela**

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Drita | 24 | 53 |
| 2. Ballkani | 24 | 51 |
| 3. Prishtina | 24 | 50 |
| 4. Gjilani | 24 | 34 |
| 5. Trepça '89 | 24 | 32 |
| 6. Feronikeli | 24 | 28 |
| 7. Llapi | 24 | 27 |
| 8. Arbëria | 24 | 26 |
| 9. Drenica | 24 | 25 |
| 10. Besa | 24 | 7 |

## SHKURT

### Kuka: Federatat duhet të funksionojnë pa pengesa

Trajneri i xhudos, Driton Kuka, ka bërë thirrje që financimi për Federatat Sportive të rregullohet sa më parë. Sipas Kukës, Federata Sportive në këtë vit ende nuk ka marrë asnjë financim nga MKRS-ja. "Federatat sportive po hyjnë në fundin e tremujorit të parë dhe ende në pritje për vlerësimin e pikëve nga Ministria, që domethënë ende asnjë financim s'ka ndodhur për vitin 2021. Çdo gjë po vonohet dhe rrjedhimisht s'ka asnjë lëvizje në këtë drejtim. Si të mbijetohet në këto situata kur tani më shumë federata për mungesë financimi s'dinë as si të sillen. Edhe kjo praktikë duhet marrë fund, financimi duhet rregulluar që federatat të jenë funksionale e jo duke pritur të zhyten në obligime. Kosova krenohet me të arriturat në sport, por duhet gjetur formën për të funksionuar pa pengesa", ka thënë Kuka.

### Ibra: Haaland do të bëhet superyll

Erling Haaland vazhdon ta impresionojë botën e futbollit. Talenti i Borussia Dortmundit mori edhe vlerësimin e Zlatan Ibrahimoviçit me të cilin e krahasojnë për stilin e lojës. "Unë kurorëzoj Halandin si superyllin e ardhshëm. Më pëlqen stili i tij, mënyra se si luan dhe më e rëndësishmja nga e gjithë mënyra se si flet. Ai flet dhe shënon, kështu duhet të jetë një futbollist. Më pëlqen", ishte komenti i yllit të Milanit.

### Ademi takim me Gravinën në Tiranë

Kryetari i Federatës i Futbollit i Kosovës, Agim Ademi dhe sekretari i Përgjithshëm, Eroll Salihu, ndodhen për vizitë pune në Tiranë, të ftuar nga presidenti i FShF-së, Armand Duka. Me këtë rast, kryetari Ademi është takuar me presidentin e Federatës së Futbollit të Italisë, Gabriele Gravina, me të cilin kanë biseduar për projekte të përbashkëta dhe avancim të bashkëpunimit. Krahas Ademit dhe Gravinës, në Tiranë ndodhet edhe presidenti i Federatës i Futbollit të Maqedonisë së Veriut, Muamed Sejdini. Në darkën e përbashkët të cilën e shtroi presidenti i FShF-së, Armand Duka, krerët e katër federatave diskutuan për format e partneritetit të mëtutjeshëm, derisa sot do të mbahet takimi katërpalësh dhe më pas do të nënshkruhen marrëveshjet e bashkëpunimit.

### Al-Khelaifi: Mbappe dhe Neymari të qëndrojnë përgjithmonë te PSG-ja

Presidenti i Paris Saint-Germainit, Nasser Al-Khelaifi, është i bindur se Kylian Mbappe dhe Neymari do të qëndrojnë në kryeqytetin francez. "Mbappe dhe Neymar janë parisienë dhe ata do të qëndrojnë përgjithmonë në Paris", ka thënë Al-Khelaifi. Presidenti i PSG-së foli edhe për barazimin e arritur kundër Barcelonës dhe kualifikimin në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. "Është nder i madh të jesh në çerekfinalet e Ligës së Kampionëve. Unë tashmë kam harruar atë që ndodhi katër vjet më parë. Do të mbetet në histori, por ne kemi luajtur dhe kemi eliminuar një ekip të shkëlqyeshëm të Barcelonës", ka përfunduar presidenti i PSG-së.

## Bach edhe një mandat në krye të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar

BERLIN, 11 MARS - Gjermani Thomas Bach është rizgjedhur në krye të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC). Gjatë sesionit numër 137 të Asamblesë së IOC, e cila u zhvillua online për shkak të pandemisë, Bach mori 93 vota në favor dhe vetëm 1 kundër. Për pasojë, 67-vjeçari rizgjidhet edhe për katër vjet të tjera në këtë detyrë. Bach është zgjedhur për herë të parë në vitin 2013 dhe më pas në vitin 2017. Ai ka qenë kampion olimpik në sportin e skermës (Montreal 1976). Pas zgjedhjes, kreu i olimpizmit botëror ka thënë se vëmendja e tij është përqendruar te Olimpiada e Tokios: "Po punojmë fort dhe konfirmoj se do të jetë një event i sigurt. Ka ende shumë gjëra për të zgjidhur, por Tokio po përgatitet më së miri".



# Spanja do t'i respektojë të gjitha simbolet e Kosovës



SEVILLA, 31 MARS - Kosova do të përfaqësohet me flamur dhe himn në ndeshjen në udhëtim ndaj Spanjës në eliminatoret e Botërorit në futboll. Kosova do të luajë kundër Spanjës me flamur dhe himnin e saj në kuadër të takimit kualifikues për Kampionatin Botëror. Edhe pse Federata e Futbollit e Spanjës në një postim fillestar iu referua Kosovës si "territor i Kosovës", mediumi spanjoll "El Confidencial" raporton se Spanja do ta presë Kosovën duke i respektuar të gjitha simbolet e shtetit tonë. Mediumi shkruan se ky është një hap vendimtar për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, pasi Spanja, e cila udhëheq grupin evropian të përbërë nga vetëm pesë vende, refuzon ta njohë sovranitetin e territorit të Ballkanit. Megjithatë, Ministria e Punëve të Jashtme e Spanjës, të cilën e citon mediumi, thotë se "politikisht kjo nuk e ndryshon pozicionin e Spanjës për Kosovën as dhe një centimetër". Mediumi spanjoll shkruan se tash janë FIFA dhe UEFA që e detyruan Spanjën të pranojë vendosjen e të gjithë simboleve të Kosovës në Sevilla, qytet ku do të zhvillohet ndeshja. Kosova do të jetë mysafire e Spanjës më 31 mars në Sevilla.

# Dallasi fiton derbin ndaj San Antonios




Dallas, 12 mars - Skuadrat e NBA-s u rikthyen në parket pas spektaklit që ofroi All Star Game, mbrëmjen e së mërkurës edhe pse u luajtën vetëm dy ndeshje. Në derbin teksan festoi Dallas Mavericks. Në "American Airlines Center" skuadra e Rick Carlisle regjistroi fitoren e katërt radhazi pasi mposhti me rezultatin 115-104 San Antonio Spursin në një ndeshje me dy tablo. Në pjesën e parë ishte formacioni i Gregg Popovichit më mirë pasi Spursi ishte në avantazhin e shtatë pikëve, por në pjesën e dytë Dallasi tregoi supermacinë e saj duke përmbysur gjithçka dhe duke e mbyllur takimin në avantazhin e 11 pikëve. 30 pikët e realizuara nga DeMare DeRozan, por edhe 11 rebounde nuk i mjaftuan San Antonios, ndërkohë që te Mavericksi spikati letonezi Kristaps Porzingis me 28 pikë e 14 rikuperime poshtë tabelës, por edhe i përhershmi Luka Doncic. Slloveni ishte thjesht fantastik duke regjistruar një tjetër triple-double, pasi e mbylli ndeshjen me 22 pikë, 12 rebounde dhe 12 asistime. Për Mavericksin kjo ishte fitorja e 19-të në këtë sezon në 35 takime në total, ndërkohë që Spursi pësoi disfatën e 15-të në 33 ndeshje, raporton "Supersport". Një fitore të thjeshtë regjistroi edhe Memphis Grizzliesi përballë Washington Wizardsin me rezultatin 127-112. Për skuadrën nga Teneesee spikati lituanezi Junas Valanciunas me 29 pikë e 20 rikuperime poshtë tabelës dhe 3 pasime deçizive, duke udhëhequr Grizzliesin drejt suksesit numër 17 në këtë sezon. Kryeqytetasit në krahun tjetër, pavarësisht prej 41 pikëve të realizuara nga dyshja Bradley Beal-Rusell Westbrook, nuk arritën ta evitonin humbjen e 21-të sezonale.

## SHKURT

### Navas: Eliminimi i Barcelonës na motivon edhe më shumë

Keylor Navas e ndali një penallti të Lionel Messit, por bëri edhe një seri mbrojtjesh të rëndësishme për t'ia siguruar Paris Saint-Germainit kalimin në çerekfinalet e Ligës së Kampionëve. "Jam shumë i lumtur, ishte një lojë e vështirë", ka thënë fillimisht Navas për RMC Sport. "Sa i përket penalltisë, është gjithmonë e vështirë për të mbrojtur, veçanërisht kundër Messit por, falë Zotit, unë isha i përqendruar dhe kjo na dha të gjithëve një nxitje", ka shtuar ai. Keylor ia kushtoi pritjen bashkëlojtarit të tij Sergio Rico dhe familjes së tij, të cilët po kalojnë një kohë të vështirë, pasi spanjolli kohën e fundit humbi babanë e tij. Portieri nga Costa Rica ka thënë, po ashtu, se eliminimi i Barcelonës është motiv për ata që të vazhdojnë në kërkim të titullit të parë të klubit në Ligën e Kampionëve. "Ne kemi motivimin për të vazhduar dhe nëse duam ta arrijmë objektivin tonë duhet të vazhdojmë në këtë drejtim", ka shtuar portieri i PSG-së.

### Rivaldo: Ramos do të ishte një blerje e mirë për Barçën

